

1

A Nuk Jam Edhe Unë Djeri?

Edituar nga

Dr. Mohsen Saleh
Mariam Itani
A. al-Kayyali

Racizmi Izraelit

Palestinezët në Izrael

Çështje Studimore



Nga

Abbas Ismail

Përkthyer nga

Iris Gjyzeli

A nuk jam edhe unë Njeri?

(1)

Nga seria e librave
që diskutojnë rreth
vuajtjeve të popullsisë
palestineze nën
pushtimin izraelit

Edituar nga
Dr. Mohsen Saleh
Mariam Itani
Abdul-Hamid al-Kayyali

Racizmi Izraelit

Palestinezët në Izrael: Çështje Studimore

nga
Abbas Ismail

**Përkthyer nga
Iris Gjyzeli**

Nga: Abbas Ismail

Përkthyer nga: Iris Gjyzeli

Edituar nga: Dr. Mohsen Saleh, Mariam Itani, Abdul-Hamid al-Kayyali

Përmbajtja

<i>Përmbajtja</i>	3
<i>Parathënie</i>	5
<i>Hyrja e përkthyesit</i>	7
<i>Hyrja e autorit</i>	9
<i>Kapitulli 1: Racizmi dhe Izraeli</i>	15
<i>Kapitulli 2: Deklarata dhe thënie raciste kundër arabëve dhe palestinezëve në Izrael</i>	21
<i>Kapitulli 3: Nivelet dhe manifestimet e racizmit izraelit</i>	29
1. Racizmi në nivelin e punësimit dhe buxhetit	31
2. Racizmi në nivelet publike	38
3. Racizmi në nivelet e drejtësisë:	43
a. Racizmi në nivelet e drejtësisë	45
b. Ligjet e tokës së konfiskuar	48
c. Ligje të tjera raciste	50
4. Racizmi në dhënien e dënimeve dhe gjykimeve	53
5. Racizmi në edukim	56
<i>Kapitulli 4: Transferimi i arabëve palestinezë nga Palestina</i>	63
<i>Kapitulli 5: Dhuna ndaj vendeve të shenjta</i>	83
<i>Mbyllje</i>	91
<i>Referencat</i>	93



Parathënie

Qendra Al-Zajtuna ka kënaqësinë të sjellë para lexuesit botimin e librit: “A nuk jam edhe unë njeri”?

Ky botim ka si qëllim t’i ofrojë lexuesit një panoramë të qartë të vuajtjeve të popullit palestinez, të shkëljes së të drejtave dhe konfiskimit të pasurive të tij. Libri hedh dritë në agoninë e përditshme të palestinezëve, të cilët janë dëbuar nga tokat e tyre, janë vrarë e burgosur, u kanë shkatërruar shtëpitë dhe u kanë dhunuar nderin. Dhuna dhe krimet kundrejt palestinezëve, ndodhin në një kohë kur bota hodhi pas vetes perden e neveritshme të kolonizimit tradicional, por është duke lënë ‘të paprekshme’ atë të sionizmit në Palestinë, duke bërë një sy qorr e një vesh shurdh ndaj dhunës sistematike dhe agresionit mizor të ushtruar ndaj banorëve autoktonë. Ironikisht, e gjitha kjo ndodh në një kohë kur e tërë bota e qytetëruar po lëviz me shpejtësi drejt koncepteve bazë të respektimit të të drejtave të njeriut, dinjitetit të tij, si dhe respektimit të së drejtës së patjetërsueshme të individit, për të jetuar i lirë e në paqe, në atdheun e vet. Megjithatë, bota moderne po shfaqet thuasjë indiferente ndaj asaj që po iu ndodh palestinezëve të shpronësuar padrejhtësisht dhe njëherazi të pafat. Palestinezët, si të gjithë të tjerët, janë qenie njerëzore me dinjitetin dhe lirinë e tyre, që përcjellin një krenari të përlligjur në kombin e tyre, si dhe me botën në tërësi. Siç janë edhe kontribues me vlera të pamohueshme për qytetërimin në botë. Kështu, të gjithë të interesuarit për marrëveshje paqësore dhe të sinqerta me ta, para se të hyjnë në detaje, duhet fillimisht të marrin parasysh se nuk është zgjidhja e duhur dhe me vend, heqja dorë nga liria, nga vetëvendosja, si dhe nga të drejtat legjitime të palestinezëve në truallin e tyre.

Ky botim i parë ka si qëllim të hedhë sadopak dritë mbi aspekte të ndryshme të jetës së palestinezëve dhe vuajtjeve të tyre të përditshme, duke u fokusuar në çështjet e grave, të fëmijëve, të të burgosurve, refugjatëve, studentëve, apo edhe aparteidit të ushtruar ndaj tyre.

Hyrja e përkthyesit

Pavarësisht nga përkthimi i këtij libri, jo shpesh marr përsipër detyrën e përkthyesit. Megjithatë, kjo nuk është pa domethënie, pasi përkthimi është një procedurë mjaft e rëndësishme. Në fakt, përkthimi nuk është vetëm një proces i lodhshëm, por gjithashtu një detyrë e vështirë, që njëherazi kërkon përpikmëri dhe rezultat të lartë. Ajo që më shtyu të marr mbi shpinë këtë përgjegjësi, së pari është rëndësia e madhe në aspektin e detyrës, që buron nga një arsye e fortë identifikimi e ndjeshmërie, si dhe nga faktet dridhëuese që ofron. E dyta, respekti dhe vlerësimi që kam për botuesin kryesor Dr. Mohsen Saleh, i cili personalisht më kërkoi ta kryeja këtë detyrë të rëndësishme. Ndërsa vazhdoja të përktheja, mbaja në mendje një numër të madh të teorive dhe të trajtimeve për përkthimin. Mes trajtimeve të tilla është ekuivalenca dinamike dhe ajo zyrtare, të cilat i përdor me qëllim që të arrij rezultatin e duhur, si dhe t'i përmbahem kontekstit që të diktohet. Kështu, kur përdor arsyetimin pragmatik ose përkthimin kontekstual si diçka të rëndësishme, përdor trajtimin e ekuivalencës dinamike, ku fokusimi është në lexueshmëri, ndërsa kur përdor arsyetimin kuptimor, ose përkthimin fjalëpërfjalë - që të ketë më shumë efikasitet - përdor trajtimin e ekuivalencës formale, ku fokusimi është fjalëpërfjalë.

Përveç kësaj, përkthimi im është i bazuar dhe i frymëzuar nga ai që njihet rëndom si përkthim në përvojë. Në një trajtim të çfarëdoshëm, kur përkthyesi përpiqet të kuptojë, zbulojë apo të përjetojë tekstin burimor, ai duhet ta lërë njëherë veten të lirë të depërtojë brenda saj, para se ta përkthejë atë në gjuhën e planifikuar. E gjitha kjo bëhet për të siguruar një lexueshmëri të lehtë, e gjithashtu një përpikmëri të nevojshme në

përkthimin e fjalëpërfjalshëm, në mënyrë që të transmetojë tek lexuesit emocionin e barazvlershëm.

“Racizmi izraelit - Palestinezët në Izrael: Një rast studimor” është një shpjegim i vyer dhe i pasur në përmbajtje, duke demaskuar e tronditur thellë faktualitetin. Gjithashtu, ai është i qartë dhe objektiv në tekst. Kjo përmbledhje na tregon se, si racizmi ashtu edhe diskriminimi, kanë qenë gjithmonë mjeti kryesor i forcës që kanë ushtruar sionistët, për të spastruar etnikisht palestinezët arabë. Pra, është një fakt që e bën shtetin izraelit, që prej fillimit të ekzistencës së tij, një shtet racist. Zoti Ismail, nëpërmjet një volumi me përmbajtje shokuese dhe të mirëdokumentuar, na sjell në vëmendje regjime të shkuara raciste, por edhe vërteton përtej çdo dyshimi, ekzistencën e dy shtresave të ndryshme qytetare, në aparteidin ekzistues izraelit.

Përkthyes

Alaadine Assaiqeli

Hyrja e autorit

Arabët besojnë se Izraeli është një shtet racist. Ky racizëm përdoret për të manipuluar me kontekstin dhe konsideratën politike, pavarësisht nga ata që mund të jenë përkrahës apo kundërshtarë të këtij përshkrimi. Në fakt, nuk është aspak e vështirë për një akademik ose studiues objektiv, për të vërtetuar racizmin e shtetit çifut. Evidencat e disponueshme të racizmit, si dhe aspektet e ndryshme të tij, janë të panumërta. Zakonisht, një studiues mund të hasë disa vështirësi për t'i renditur e klasifikuar këto aspekte të pamata e të shumëllojshme të racizmit, ashtu si dhe qëllimet e tij.

Është e panevojshme të them që fenomeni i racizmit, ngërthen në përgjithësi aspekte të shumëllojshme dhe nivele, të cilat ndryshojnë nga rëndësia dhe serioziteti i tyre. Megjithatë, të gjitha aspektet dhe format e racizmit janë faj i brendshëm, por mbeten tmerruese dhe të rrezikshme,



edhe për më tutje se kaq. Më e keqja e të gjithave, është sepse përdoret nga një regjim i caktuar kundër qytetarëve të tij. Nëse qytetarët e një shteti të caktuar janë subjekt i diskriminimeve dhe paragjyqimeve, vetëm se ata i përkasin një feje dhe një kombi të ndryshëm nga ata që kanë në krye, atëherë nuk është çudi kur një grup fetar apo një kombësi tjetër, bëhet subjekt i diskriminimeve dhe praktikimit të racizmit, nga i njëjti shtet.

Qëllimi i kësaj hyrjeje të shkurtër është të konstatojë nëse shteti çifut praktikon aparteid kundër palestinezëve të vitit 1948, “Palestinezët në Izrael”, të cilët nga ana civile konsiderohen si “Qytetarë Izraelitë”.

Atëherë, asgjë nuk mund ta ndalojë praktikimin e racizmit të pandreqshëm e diskriminues kundër palestinezëve të Bregut Perëndimor (West Bank) dhe atyre të Rripit të Gazës, duke përfshirë në veçanti arabët dhe muslimanët .

“....kërkesat e sionistëve për një shtet çifut ishin në kundërshtim me të gjitha parimet e historisë moderne dhe ligjin ndërkombëtar.”

► Nahum Goldmann,

“The Psychology of Middle East Peace,” në revistën Foreign Affairs, tetor 1975, p.114



Ky është një fakt që dallon me lehtësi shumë tipare të racizmit izraelit dhe politikës së aparteidit, nëpërmjet pushtimit të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës. Ashtu si dhe nëpërmjet dhunës e agresionit të ushtruar kundër gjithçkaje që është palestineze, qofshin ata njerëz, pemë, madje edhe gurë. Prej këtujve dallohet qartë racizmi i tejmase përhapur ndaj palestinezëve që jetojnë në Izrael, të cilët

duhet të jenë pjesë integrale në “kombësinë izraelite”.

Nëse ndokush përballet me realitetin e sundimit të huaj dhe sjelljen e tij kundër popullit palestinez në Bregun Perëndimor dhe në atë të Rripit



të Gazës, do të dallojë qartë racizmin që kanë çifutët ndaj popullatës. Kjo gjë, në radhë të parë na tregon se, ai që praktikon racizmin dhe diskriminimin kundër popullit të tij, nuk do të ketë skrupuj t'i përdorë ato edhe tek te tjerët. Së dyti, mund të theksojmë se racizmi dhe diskriminimi, jo medoemos, duhet të kenë lidhje me sundimin. Këto e kanë zanafillën te thelbi i mendimit sionist, prandaj edhe janë një element natyror dhe përzgjedhës, në strukturën e tyre. Kjo është edhe arsyeja përse ekziston një marrëdhënie raciste dhe lidhje organike mes racizmit dhe sionizmit. Një fakt të cilin e kanë konfirmuar edhe Kombet e Bashkuara, ku rezoluta nr. 3379 e datës 10.10.1975, thekson se “e konsiderojnë sionizmin si një formë raciste”. Nëse arrijmë të kuptojmë që Izraeli ka lindur nga sionizmi dhe është mishërimi zyrtar i mendimit sionist, rezulton tepër qartë se shteti izraelit është tejmase racist dhe rezoluta e Kombeve të Bashkuara, nuk është e vendosur ashtu rastësisht, apo pse ata kanë afekcion për popullin palestinez dhe për arabët. Rezoluta u lëshua në bazë të fakteve bindëse, si dhe nga ngjarjet që janë vërtetuar prej tyre, nga agjensitë e specializuara që merren me të drejtat e njeriut, siç edhe është paraprirë në rezolutat e ndryshme, apo edhe në konferencat ndërkombëtare. Më poshtë vijojnë disa nga këto rezoluta:¹

- **Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të K.B. nr.315 , datë 14.12.1973, e cila flet për aleancën midis aparteidit të Afrikës së Jugut dhe sionizmit.**
- **Në deklaratën e Meksikës së vitit 1975, ku flitej për barazinë e grave dhe kontributin e tyre për zhvillim dhe paqe, e cila u adoptua më pas nga “Konferenca botërore e vitit të Grave”, theksohet:**

“Bashkëpunimi dhe paqja botërore, kërkon arritjen e lirisë dhe pavarësisë, eliminimin e kolonizimit dhe neo-kolonizimit, të sundimit të huaj, sionizmit, aparteidit dhe diskriminimit



racor, në të gjitha format e tij. Gjithashtu, njohjen e dinjitetit të popujve dhe të të drejtave të tyre për vetëvendosje”.

- **Rezoluta që u mor nga Asambleja e Kryetarëve të Shtetit dhe Qeverisë së Organizatës së Bashkimit Afrikan, e cila u mbajt në Kampala, Uganda, nga d.t. 28.7.1975 deri më 1.8.1975 theksoi:**

“Regjimi racist në Palestinën e pushtuar dhe regjimi racist në Zimbabve dhe Afrikën e Jugut, kanë një origjinë të përbashkët imperialiste, duke formuar një tërësi, si dhe duke pasur të njëjtat struktura raciste, duke qenë të lidhur organikisht me politikën e tyre, që ka si synim cënimin e dinjitetit dhe të integritetit të njeriut”. 2

- **Kjo është shtojcë e rezolutave dhe deklaratave të tjera ndërkombëtare, që së bashku me formulimet e bëra nga shumë intelektualë në botë, si dhe nga partizanët e politikës dhe të sundimit të ligjit, e kanë përcaktuar sionizmin si një lëvizje të qartë raciste.**

Këtu vlen të përmendim tërheqjen e K.B. nga rezoluta e tyre, e cila e konsideron sionizmin si një lloj racizmi, e nuk ndryshon asgjë nga realiteti i këtij racizmi. Kjo rezolutë erdhi si pasojë e disbalancimit të fuqive ndërkombëtare, çka do të thotë se erdhi si një arsye politike. Në veçanti, ajo nuk ka ndjekur ndonjë ndryshim në linjë, as në nivelin e regjimit dhe as në nivelin e procedurave të përdorura në përgjithësi ndaj palestinezëve, sidomos atyre në Izrael. Ndryshe nga çfarë ndodhi në Afrikën e Jugut.



Shpallja e Shtetit të Izraelit

Forcat britanike u tërhoqën nga Palestina më 14.5.1948, dhe po në këtë ditë, David Ben Gurion shpalli themelimin e shtetit të Izraelit, “dhe kthimin e popullit çifut në tokën historike të tij.” Kështu deklarimi i Izraelit si një “shtet çifut” u shpall pa ndonjë kufi gjeografik apo kushtetutë, duke shkelur ligjin dhe normat më të thjeshta ndërkombëtare, duke e shpallur atë si një “shtet që është mbi çdo ligji.”



Kapitulli 1: Racizmi dhe Izraeli

“Viti 2006 ka ofruar një rritje domethënëse në llojet e racizmit, e në pjesën më të madhe të popullsisë çifute ndaj shtetasve arabë (palestinezëve në Izrael). Votimi gjithashtu na tregon se 62% e të anketuarve, mbështesin idenë që t’i detyrojnë arabët të largohen nga vendi i tyre, ndërsa më shumë se 40%, përkrahin ndarjen raciale”³.

Në fakt, nuk mund ta deformojmë realitetin, nëse shohim se politika, shoqëria dhe aspekti ligjor, shpërfaqin një lloj racizmi prototip, si në aspektin shoqëror ashtu edhe në atë shtetëror, ku përkufizimet dhe zbatimet e teorive të racizmit dhe diskriminimit, janë vënë në jetë në mënyrë efçente. Ky është thujse shembulli i vetëm e krejtësisht unik, e mëse i qartë në këtë drejtim, pas rrëzimit të regjimit dhe ligjeve të aparteidit, si dhe racizmit të shekullit të kaluar (diskriminimi kundër zezakëve të Amerikës dhe sistemi i aparteidit në Afrikën e Jugut.)



“Ne jemi të mbeturit e mallkuar të Evropës, çifutët të cilët Evropa nuk arriti ti zhdukte. Ne jemi vendi ku ëndërrat naziste jetojnë dhe ekzistojnë, të cilat janë ngulur thellë në mendjen e mbijetuesëve; dhe tek pasardhësit e tyre; dhe të atyre të cilët janë mbytur nga retorikat e pafundme që kanë ngritur lartë Holokausin. Ne jemi vendi i fundit në Evropë ku e shkuara naziste akoma prodhon fryte, por shteti i ka kthyer mbeturinat çifute evropiane në një trashëgimi kombëtare, një dritë për jo-çifutët dhe një kompesim për çifutët. Ne jemi modeli i orientalizmit evropian i cili befaz u bë prezent në lindje, pa dinjitet dhe vetëdije. Ne jemi një vend eksperimental për parimet vetiake e universale të cilat Evropa ka dështuar ti çojë përtej limitit - i cili është përhapja e së keqes: çdo qenie njerëzore mund ta gjej vetëveten pjesëmarrës në atë përzierje të tmerrshme e cila varion ndërmjet urrejtjes së të huajve dhe persekutimit, poshtërimit dhe diskriminimit, mbyllje së kampeve dhe pastrimit etnik të jetëve dhe të qyteteve kjo e keqe mund të godas secilin nga ne, secilin, madje dhe ata që kanë qenë viktima.”



► Profesori i asociuar izraelit dhe filozofi Adi Ophir në shkrimin: “Mi’at Sanah ‘Ala al-Mu’tamar al-Suhyuni al-‘Awël: Hisab” (Një qind vjet pas Kongresit të Parë Sionist: një Dëshmi), (Riesling 5, 1998), gazeta Al-Ayyam, Palestinë, marrë nga gazeta Ma’arif, 10.3.2007.



Sipas përkufizimit klasik, racizmi është konsideruar si një teori bio-antropologjike, që e sheh botën të ndarë në raca dhe klasa. Nga njëra anë, ndodhen pronarët, të cilët veçoria biologjike dhe cilësitë i klasifikojnë më lartë se gjithë të tjerët, atje ku duhet të jenë që të kontrollojnë botën. Nga ana tjetër, ndodhen të pavlefshmit, që i përkasin shtresës së ulët, të cilët nuk gëzojnë të drejtën e veçorive biologjike apo cilësore. Rrjedhimisht, këta duhet të jenë shërbyes dhe duhet të mbahen nën kontroll të rreptë.

Pavarësisht nga fakti i teorisë bio-antropologjike, që shpjegon se racizmi u zhvillua në shek. e 19-të, që në fillim të historisë së tij, termi “racizëm” sot ka marrë domethënie të ndryshme, madje edhe më specifike. Përkufizimet e reja apo ngjyrimet e racizmit, nuk theksojnë ndjenja superiore në bazë të etnicitetit apo racës, por thuajse përpiqen të përfshijnë ndjenjat e superioritetit ndaj kategorive të tjera, si ato kombëtare, gjuhësore, fetare etj⁴.

Nëse në të shkuarën fjala “racizëm”, sipas bio-antropologjisë, shprehte thjesht superioritet, sot ajo shpreh superioritet të individëve. D.m.th. një grup individësh që i përkasin një grupi specifik, që e ndjejnë veten më superiorë ndaj një grupi tjetër, apo ndaj grupeve të tjera të popullatës.

Sot, përdorimi i kësaj fjale nuk përfshin vetëm terma që i përkasin ndryshimeve biologjike, por gjithashtu edhe ide që i përkasin qënies së ndryshimit mes individëve, të cilët u përkasin grupimeve të ndryshme sociale e kulturore. Sipas këtij përkufizimi, racizmi ekziston kudo që pretendohet se gjendet një dallim mes individëve të grupit (A) dhe atij të grupit (B). Kjo është arsyeja që një person nga grupi A nuk sillet në të njëjtën mënyrë me një person të grupit B, apo siç sillet me ata të grupit A.⁵



Fjala racizëm është e përhapur gjerësisht në ato vende që nuk kanë lidhje me racën. Ky përkufizim banal është përvetësuar nga kuvendi ndërkombëtar mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (1965). Ky kuvend, përbën kuvendimin qendror dhe më të rëndësishmin për të luftuar racizmin. Neni i parë i këtij kuvendi e përkufizon diskriminimin racial si: “çdo dallim, përjashtim, frenim apo preferencë të bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje, etnicitet apo origjinë kombëtare, e cila ka si qëllim të zhvleftësojë apo të dëmtojë identifikimin, kënaqësinë ose ushtrimin e një qëndrimi të njëjlojtë, në të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në politikë, ekonomi, shoqëri, kulturë, ashtu si edhe në çdo fushë të jetës publike”.

Racizmi ose diskriminimi në vetvete, përbën një shkelje të rëndë të të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Gjithashtu, ia heq lirinë themelore disa popullatave të caktuara, vetëm se ato janë të ndryshme në ngjyrë, racë, kombësi, etnicitet dhe origjinë. Kështu, kjo përbën një dhunim të egër në parimet e barazisë, të dinjitetit dhe vlerësimit të njeriut, të cilat janë konsideruar si dy parimet kryesore dhe thelbësore, ndaj të cilave të gjithë teoritë mbi të drejtat njerëzore, si dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, janë të fokusuar e të ngulitura fort, qysh prej vitit 1948. Për shkak të shkeljeve të rënda dhe pasojave katastrofike të teorisë së racizmit, prej së cilës njerëzimi ka vuajtur shumë, ajo është vetmja doktrinë politike në të cilën ligji ndërkombëtar ka dalluar shkeljen e të drejtave të njeriut, e që konsiderohet si e jashtëligjshme⁶.



Policët izraelitë duke dhunuar një protestues arab në Izrael përpara zyrës së kryeministrit në Jeruzalemin e pushtuar, gjatë një demonstrate, ku morën pjesë rreth 2000 arabë, të cilët kërkonin të drejtat e tyre dhe dhënien fund të diskriminit kundër tyre.

► AFP, 24/11/1999.



Kapitulli 2: Deklarata dhe thënie raciste kundër arabëve dhe palestinezëve në Izrael

Studjuesve mund t'u duket e pamundur për t'i numëruar thëniet raciste të bëra nga udhëheqësit sionistë dhe zyrtarët e lartë çifutë ndaj arabëve, dhe në veçanti ndaj palestinezëve. Arkivat e tyre janë plot me deklarata dhe deklarime raciste, individuale apo edhe institucionale. Megjithatë, do të përqëndrohemi tek ato të kohëve të fundit. Këto thënie dhe deklarata reflektojnë natyrën, karakterin e ndjenjës dhe këndvështrimet raciste, që ata kanë apo ndjejnë ndaj arabëve palestinezë.

Ministri i Ndërtimit dhe Banesave, Effie Eitami, në një intervistë të dhënë në gazetën "Haaretz", i ka përshkruar palestinezët që jetojnë në Izrael si "bombë e kohës, si një kërcënim ekzistues, siç është sëmundja e kancerit, apo edhe si kolona e pestë".⁷



Me kë ngjajmë ne”

Koha për racizëm, dënime kolektive dhe dhunë verbale është në fazën më të lartë të saj. Çfarë ishte konsideruar njëherë çmenduri e thashethemexhinjëve dhe dëgjuesëve të çmendur të radios, tani është një gjë politikisht korrekt, që gëzon konsensusin e zërave çjerrës në ligjërimet e nxehta izraelite. “Ne na është lejuar të kemi një tjetër Kfar Kana, na lejohet të shkatërrojmë çdo gjë,” deklaroi ministri i drejtësisë në kohën e Haim Ramon, njeriu që ishte përgjegjës për ruajtjen e ligjit. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë Eli Yishai, përfaqësues i partisë fetare që ka një udhëheqje “shpirtërore” nuk ka ngelur: Ai propozon që të godasin infrastrukturën në Liban dhe “shfarrosin” fshatra. Këto dy thirrje për të kryer krime lufte nuk kanë dola nga goja e përfaqësuesve të të djathtës ekstreme. Ramon dhe Yishai kanë ngelur deri më sot zëdhënës legjitim në pushtet. As gjeneralët nuk kanë qëndruar prapa: “Grijeni Libanin. Ktheheni atë në një muzeum të ankthit të tmerrshëm,” propozoi kryekomandanti i shtabit të Veriut, brigadieri gjeneral Rafi Noy, një analist i zellshëm i programeve mediatike.

Raketat kasam kanë nxitur edhe më tej dëshirat sadiste, kësaj here edhe në poezi. “Nëse çatitë shkatërrohen, shkatërroni edhe themelet ... sulmoni Libanin dhe Gazën me plug dhe me kripë, shkatërrojni ato kështu që asnjë banor të mos ngelet në këmbë. Kthejini ato në një shkretëtirë të shkretë, grumbull plehrash... vritini ata, derdhjani gjakun, trëmbjani jetët,” shkruan poeti Ilan Scheinfeld, i cili kohët



e fundit ka botuar një novelë, të cilën asnjë njeri nuk ka kërkuar ta bojkotojë. Ish-krye rabini Mordechai Eliahu... ministëri i çështjeve të pensionit Rafi Eitan... ministri i rendit publik Avi Dichter... pasuesi i tij në shërbimet e sigurisë Shin Bet, Yuval Diskin.. Gjeneral majori Amiram Levin... ish-ministri i drejtësisë Yosef Lapid.... Ish-kryetari i stafit Moshe Ya'alon... bashkiaku i Sderotit Eli Moyal... asnjëri nga këta nuk është ndëshkuar për fjalët e tyre, e asnjëri prej tyre nuk është shmangur.

Kjo është ajo me të cilën ngajmë ne. Ky është portreti ynë moral.

► Gideon Levi, gazeta *Haaretz*, 10/6/2007.

Më 22.2.2004. zëvendës-ministri i mbrojtjes Ze'ev Boim, ngriti një pyetje përçmuese “ çfarë është Islami në tërësi dhe palestinezët në veçanti”? A është një formë e humbur kulturore apo një difekt gjenetik?

Ky deklaram u mbështet edhe nga deputeti i Likudit, Yehiel Hazan në Knesset (MK), i cili tha: “ajo çka deklaroi Boim, nuk është studiuar ende. Por sipas eksperiencës sime, kjo është e vërtetë. Mendoj se ai ka të drejtë”. “Dihet mirë që arabët i kanë therrur dhe vranë çifutët për më shumë se një gjeneratë. Mendoj se ata i kanë në gjak vrasjet, d.m.th. është diçka gjenetike. Unë nuk i kam studiuar këto, por mund të gjej më një mënyrë tjetër për ta shpjeguar këtë gjë”, ndërsa Hazan shtoi: “Mos i besoni një arabi, bile dhe atij që ka vdekur qysh prej 40 vitesh”.⁸



Më 13/2/2004, gjatë një diskutimi në Knesset (parlamenti çifut), Jehiel Hazan ka deklaruar se “Arabët janë krimba, ju mund t’i gjeni ata kudo, si nën tokë ashtu edhe mbi tokë”.

Ndërsa ministri i brendshëm Gideon Ezra i ka përshkruar arabët si një fatkeqësi e madhe, duke deklaruar: “ Në shtetin tonë ka shtetas arabë dhe kjo është një fatkeqësi tepër e madhe për ne. Ju keni mbaruar me Gazën, ju keni mbaruar me Xhudaean dhe Samarian (BP), por ne qendrojmë aty me fatkeqësinë më të madhe”.⁹

Ministri i Turizmit Binjamini “Benny” Elon, gjatë një takimi të bërë me një grup misionarësh kristianë nga SHBA, në shkurt të 2004-ës, i nxiti ata që t’i konvertonin muslimanët në të krishterë. Ai u tha që të “shkonin xhami më xhami, për t’i treguar muslimanëve dritën e së vërtetës. Bindini vrasësit muslimanë, të cilët kanë harruar se vrasja është e ndaluar dhe kthejini ata në besimtarë kristianë dhe në njerëz të mirë”.¹⁰

Profesori David Bukay, i Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale në universitetin “Haifa”, është shprehur në disa prej leksioneve të tij nxitëse dhe paragjykuese: “Terrorizmi është një problem arab dhe profeti Muhamed është terroristi i parë”. Gjithashtu ai ka thënë: “Arabët janë të dhënë pas alkolit dhe seksit... ata janë budallenj dhe nuk kanë kontribuar aspak për njerzimin”.¹¹

Shumë deklarime të tjera janë shfaqur nëpër media. Ato kanë qarkulluar nga gazetarët dhe intelektualët. Më poshtë kemi përmendur me bollëk deklarime raciste dhe nxitëse të urrejtjes, të bëra prej tyre.

Gazeta “Nativ”, e botuar nga Qendra Ariel për Studime Politike, në një artikull të publikuar në Maj të vitit 2003, krahasonte Islamin me Nazizmin dhe profetin Muhamed me Hitlerin.¹²

Pjesa më e madhe e rabinëve kanë shprehur hapur racizmin dhe urrejtjen e tyre ndaj arabëve. Lidhur me këtë çështje, rabini Benzioni



Mutzaferi, në mars të 2003-it, shprehu hapur kënaqësinë e tij për tre shtetasit arabë të vvarë: “Rroftë populli çifut, çrrënjosje e mbarë! Ata ikën. Ne duhet të gëzohemi kur të tjerët qajnë, pra lërin ata të qajnë dhe lërin ata pa fëmijët e tyre, ndërsa ne dëfremjë e vallëzojmë”.¹³

Udhëheqësi shpirtëror i partisë Shas, rabini Ovadia Jozef shfaq hapur racizmin e tij ndaj popullit arab, duke deklaruar: “Për ne, arabët janë si plehra.” Eshtë po ky rabin që i përshkruan vazhdimisht arabët si gjarpërinj dhe i konsideron ata edhe si bisha. Ai gjithashtu ka thënë se nuk ka njerëz më të egër se sa arabët, dhe se Zoti është penduar që i ka krijuar ata. Gjithashtu, ai i ka bërë thirrje për të asgjësuar të gjithë arabët”.¹⁴

Në të njëjtën mënyrë është shprehur edhe komandanti i komandës së rajonit qendror të ushtrisë izraelite, në një nga letrat e tij:

“Kur forcat tona u ndeshën me civilët gjatë një lufte apo konflikti me intensitet të lartë, dhe nuk ishte e qartë nëse ata civilë ishin të paafte për të cënuar forcat tona, sipas vendimit të halaka (ligjet çifute), lejohet, madje është e detyruar për t’i vvarë ata... nuk lejohet besimi i një arabi në asnjë rrethanë... gjatë luftës kur forcat tona sulmojnë armikun, sipas ligjeve të halakisë, ata janë të detyruar të vrasin edhe civilët më të mirë, pra njerëzit e pafajshëm.”¹⁵

Deklarime raciste janë bërë edhe nga rabini (mjeshtri ose mësuesi i fesë çifute) i parë i qytetit të Safadit, pra nga kryetari i mëparshëm i mësuesve sefarditë të Izraelit, si edhe nga kryetari i mësuesve sefarditë të qytetit të Bat Jam, po ashtu edhe nga krerët e shkollave fetare të Jeruzalemit.¹⁶


Deklarimet e bëra nga deputetët e Knesset-it, si dhe nga zyrtarët e lartë ndaj palestinezëve të Izraelit, shfaqin një mori tiparesh raciste. Disa nga këto deklarata janë bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa



disa të tjera tërthorazi, apo edhe në mënyrë të fshehtë. Thëniet më të rënda që janë bërë në mënyrë indirekte janë ato të rubrikës “Shkëmbimi i tokës”, e cila hyn në kategorinë e “transferimit të popullatës”. Kjo vjen me pretekstin e paqes, nevojës për të mbrojtur identitetin e shtetit çifut. Ky deklaram nënkupton faktin që prononcimet vijnë nga deputetët e Kneset-it, pra prej të gjitha partive dhe orientimeve politike, të të gjitha niveleve.

Ministra si Ehud Barak, Benjamin Netanyahu, Ephraim Sneh, Avigdor Liberman, Benny Alon (ish-presidenti i partisë raciste të Moledetit) dhe Eli Yishai, së bashku me ish-ministrat dhe ministrat e tanishëm¹⁷, janë të gjithë shembuj të politikanëve çifutë që shprehin hapur deklarata raciste, në këtë rubrikë dhe për këtë këndvështrim.¹⁸ Disa prej akademikëve dhe intelektualëve që ndajnë me ta të njëjtin mendim, janë edhe Arnon Sofer, profesor në Universitetin Hafa, Shlomo Gazit, studiues në Qendrën e Studimit Strategjik Jaffee (JCSS) - tani njihet si Qendra e Studimit të Sigurisë Kombëtare - INSS, dhe ish-këshilltari ligjor i qeverisë, Elyakim Rubinstein.¹⁹

Të gjitha figurat e përmendura më sipër, kanë mbështetur, propozuar dhe deklaruar haptazi eliminimin e “shtetasve arabë” nga shteti i tyre hebre.



Kjo është fotografia e Meir Kahane, themeluesit të lëvizjes Kach, qëllimi i së cilës është racizmi kundër arabëve. Themelimi i Kach-it daton me themelimin e Lidhjes së Mbrojtjes Çifute (Jewish Defense League, JDL), e themeluar po ashtu nga Kahane në New York në 1968. JDL nisi aktivitetin e saj në Izrael në 1971, pas emigrimit të Kahanes. Më pas, JDL u kthye në një lëvizje politike dhe pak para votimeve që u zhvilluan në 1973 mori emrin Kach. Kach u bë shumë aktive gjatë viteve 1980-të. Udhëheqësi i Kach-it, Kahane u vra në Manhattan në 1991.



Kapitulli 3: Nivelet dhe manifestimet e racizmit çifut

Nuk gjejmë asnjë aspekt të jetës apo të realitetit të popullsisë palestineze që jeton në Izrael, që të mos kenë qenë diskriminues, apo të mos ketë qenë subjekt i racizmit nga ana e çifutëve. Racizmi dhe diskriminimi çifut, sipas përkufizimeve të përmendura më sipër, manifestohen shumë qartë në të gjitha sferat e jetës, duke filluar që nga aspekti fetar dhe ai ideologjik i lëvizjes sioniste, e deri në praktikimin e tyre ndaj popullatës palestineze. Më pas, duke përfunduar me ligjet e miratuara në parlamentin çifut (Knesset), që garantojnë vlefshmërinë e diskriminimit dhe izolimit ndaj palestinezëve.

Një karakteristikë e spikatur e fenomenit të racizmit, që vijon përgjatë gjithë historisë së lëvizjes sioniste, është kuptueshmëria dhe qëndrueshmëria. Me fjalë të tjera, racizmi që ka shoqëruar sionizmin ka



Postëblloku Ushtarak “al-Fawakih”: Një Pikturë e Racizmit Izraelit

Në postëbllokun ushtarak “al-Fawakih” (që do të thotë Fruta), në jug të qytetit të Kalkilijas në Bregun Perëndimor, ekzistojnë tre rrugë, në krye të secilës qëndron një ushtarë, detyra e të cilit është thjeshtë diskriminimi racial.

Punëtori Muhamed Daud nga Kalkiljah rrëfen sesi ushtarët e postëbllokut sillen me këmbësorët, ku çdo person që ngjan si arab në mesin e kolonëve çifutë, ndalohet. Megjithatë pas kontrollit të kartave të identitetit, një keqardhje i afrohet ku edhe i thuhet, “Na vjen keq. Kemi menduar se jeni një arab”

Palestinezët që jetojnë në qytetet arabe që ndodhen brenda Vijës së Gjelbër i quajnë këto postëblloque si “postëbllonet e diskriminimit” për arsye të diskriminimit flagrant që ushtrohet në to, i cili nuk vjen vetëm me fjalë sharëse dhe mallkuese por edhe me gjoba. Këto gjoba i vihen arabëve, në shumicën e rasteve duke mos qënë në kundravajtje. Arsyeja e vetme e gjobitjes është, që të ndalojnë arabët për të mos bërë pazar jashtë qytetit të Kalkiljas.

Amxhad ‘Odah, nga fshati i Xhalxhulija, rrëfen: “një nga ushtarët më tha se është shumë e rëndësishme që të mos shkoj në Kalkilija, pasi ai është një qytet terrorist dhe shtetasit izraelitë nuk duhet të shkojnë atje, madje edhe nëse janë arabë, pasi të hysh në të është sikur të hysh në një çerdhe terroristësh.” Amxhadi thotë unë jam përgjigjur, se të ardhurit kanë ardhur nga qytetet e Izraelit dhe janë vendosur në tokat që nuk i përkasin atyre. Këta nuk mund të rrinë në Bregun Perëndimor, por edhe ne, kemi kushërijtë aty dhe këto mure dhe këto pengesa që na ndajnë. Pas kësaj Amxhadi tregon që ushtari i është përgjigjur: “arab i qelbur”

► *Gazeta Alghad*, ‘Amman, 4/3/2007.



qenë gjithmonë tipar dhe pjesë lidhëse e strukturës së kushtetutës dhe ideologjisë së saj - si para, ashtu dhe pas themelimit të shtetit çifut - e duke vazhduar deri në ditët e sotme. Kjo është manifestuar jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra, si edhe me legjislacionin përkatës. Aktualisht, racizmi është ushtruar në të gjitha fazat dhe nivelet e politikës, të dëshmuara këto nga vetë çifutët dhe qeveritë e tyre pasardhëse, pavarësisht nga orientimi politik i tyre. Kjo është një karakteristikë thelbësore, që tregon qartazi faktin e racizmit ndaj palestinezëve, jashtë çdo dallimi politik dhe mospërputhjeje brenda tendencave të ndryshme në Izrael.

Ky fenomen është shfaqur gjatë gjithë viteve, si një “zakon i deklaruar”, prandaj ka gjetur përdorim dhe përhapje të gjerë. Totali i rasteve të ndodhura, klasifikohet sipas kategorisë së diskriminimit. P.sh., gjatë 8 muajve të parë të vitit 2006, diskriminimi ka arritur në 274 raste. Pra, kemi një rritje prej 21% të rasteve të racizmit, krahasur me atë të vitit 2005, gjatë të cilit numri i rasteve të regjistruara arriti në 225.²⁰

1. Racizmi në nivelin e punësimit dhe buxhetit

Çdo aspekt shoqëror dhe ekonomik i jetës, dëshmon mbi racizmin dhe diskriminimin që çifutët bëjnë ndaj popullatës palestineze. Ekziston një konsensus çifuto-arab, që ky diskriminim dhe izolim nuk është ashtu kuturu e nuk bëhet vetvetiu, por i strukturuar dhe i prekshëm. Kjo shkon përtej faktorëve politikë dhe nuk kufizohet në asnjë periudhë kohe, pasi i ka rrënjët dhe themelet të vendosura thellë. Ky diskriminim është praktikuar nga drejtues e politikanë të ndryshëm çifutë që kanë qenë në pushtet. Pra, diskriminimi ka qenë aty për shumë dekada, si dhe ekziston akoma në ditët e sotme. Gjithashtu, pritet që të vazhdojë për sa kohë që Izraeli e quan veten një “shtet çifut”.



Për shkak të natyrës konçize të kësaj përmbledhjeje, nuk mund t'i tregojmë me detaje aspektet e ndryshme e të shumëllojshme të diskriminimit që çifutët i bëjnë palestinezëve. Prandaj, do t'iu ofrojmë vetëm një përmbledhje të shabllonit përfaqësues të realitetit të diskriminimit dhe izolimit që ushtrohet në mënyrë sistematike nga qeveria çifute, mbi politikat sociale dhe ekonomike që ata ndjekin kundër shtetasve palestinezë.

Shumë qendra institutesh dhe komunitetesh në Izrael, japin raporte periodike për kushtet e palestinezëve në Izrael. Një prej këtyre qendrave është ajo Mossawa: Qendra për Mbrojtjen e Shtetasve Arabë në Izrael, e cila publikon raporte periodike dhe vjetore, që njihen për besueshmërinë e lartë dhe autentike të të dhënave të dokumentuara.

Në një nga raportet e buxhetit të shtetit dhe shtetasve arabë, konkretisht, në raportin ekonomik-shoqëror të vitit 2004, tregohet se palestinezët e punësuar në shërbimet shtetërore zënë 5% të totalit të punëtorëve në shtet. Pavarësisht nga fakti se palestinezët përbëjnë 20% të popullsisë në Izrael, dhe faktit tjetër se 37% e tyre kanë kryer studimet universitare.

Në një pyetësor të publikuar në tetor të vitit 2004 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Kombëtare, për tarifatat e të ardhurave dhe të rrogës në qytete, sipas disa variablave ekonomikë, tregohet se tarifatat e nivelit të rrogës vjetore tek qytetet arabe, arritën rreth 63%, krahasuar me atë të qyteteve çifute.

Sipas raportit të buxhetit shtetëror në vitin 2005, rezultoi se shtetasit arabë nuk merrnin më shumë se 5% të buxhetit për zhvillimin publik dhe më pak se 4% të buxhetit, për zhvillimin e edukimit, që ishte caktuar për “minoritetin” në vitin 2005. Për më tepër, raporti na tregon



se Ministria e Ndërtimeve dhe e Banesave, u kishte caktuar shtetasve arabë 1% nga buxheti që kishin planifikuar për vitin 2005, si dhe 2% të buxhetit që ishte caktuar nga Ministria e Turizmit.

Ndërsa buxheti që kishte caktuar Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural për “minoritetin etnik”, arrinte në vetëm 1% të shumës së buxhetit të ministrisë. Ministrisë së Mirëqënies iu dha vetëm 8% e buxhetit të autoriteteve vendore arabe. Po t’i përmbledhim, shikojmë se deri në çfarë mase shpenzon Ministria e Mirëqënies për palestinezët, shifër e cila është 30% më e ulët se ajo që shpenzon për shtetasit çifutë.²¹

Sa i përket tarifës së varfërisë, raporti i kryer për varfërinë nga Instituti i Sigurimeve Kombëtare Izraelite në nëntor të vitit 2004, na tregon se në vitin 2003, përqindja e varfërisë në familjet arabe kishte arritur në 48.4%, ndërsa përqindja tek familjet e varfëra çifute ishte 14.9%. Kjo tregon se përqindja e familjeve të varfëra arabe është tre herë më shumë se ajo e familjeve çifute.

Ndërsa varfëria e fëmijëve arabë kap shifrën e 50% të totalit të fëmijëve të varfër, që banojnë në shtetin çifut, pavarësisht nga fakti që këta fëmijë përbëjnë 30% të fëmijëve në shtet.

Qendra arabe Mada al-Carmal për studimin e aplikimit social, kohët e fundit ka llogaritur nivelin e varfërisë tek arabët, duke përfshirë këtu edhe të dhënat e përgjithshme, të cilat janë publikuar nga ana e zyrtarëve çifutë. Si përfundim, një në tre familje arabe jeton nën nivelin e varfërisë. Ndërsa 35% e familjeve arabe jetojnë në varfëri të plotë, në krahasim me 16% të familjeve çifute, ndërsa 20.5% e tyre jetojnë në nivelin mesatar. Këto të dhëna janë marrë pas ndërhyrjes së shtetit në caktimin e sigurimeve dhe taksave.



Ndërsa, para se shteti të ndërhynte në caktimin e sigurimeve dhe taksave, përqindja tek familjet arabe që jetonin nën nivelin e varfërisë, kishte arritur në 59%, shifër e cila na lë të kuptojmë se me ndërhyrjen e shtetit, 23% e popullsisë arabe doli jashtë rrethit të nivelit të varfërisë, ndërsa përqindjen e familjeve të varfëra çifute, shteti e uli në 50%. Sakaq, 39.2% e çifutëve jetojnë në nivelin mesatar.²²

Një tjetër raport i llogaritur nga Qendra Mossaua, tregon se 350 mijë fëmijë arabë jetojnë nën nivelin e varfërisë, ku këta fëmijë përbëjnë 50% të fëmijëve të varfër në shtet. Gjithashtu, raporti na tregon se 6 në 10 fëmijë arabë janë të varfër, dhe më shumë se 40% nga një milion e gjysëm të varfër në shtet, janë arabë. Ky raport gjithashtu na tregon se 130 mijë familje arabe jetojnë nën nivelin e varfërisë, dhe se gjysma e familjeve arabe janë të varfëra, ku 1/3 e familjeve të varfëra në shtet, janë arabe.²³

Për më tepër, Qendra Arabe për Planin Alternativ (ACAP) ka kryer një studim shkencor, ku ka zbuluar frymën e politikës raciste dhe diskriminuese çifute, nëpërmjet realitetit shoqëror dhe ekonomik të palestinezëve në shtetin çifut. Kjo është e bazuar nga të dhënat e Qendrës së Qarkut Statistikor, e cila i klasifikon çdo vit autoritetet lokale të vendit në 10 kategori, të cilat quhen Tufëza(Clusters). Ky klasifikim bëhet në bazë të kriterit social-ekonomik. Klasteri i parë përfshin gjendjen më të ulët social-ekonomike, ndërsa klasteri i dhjetë përfshin qytetet me aftësi moderne dhe standardet e jetesës luksoze. Klasifikimi na zbulon se pjesa më e madhe e popullsisë arabe, pra 89%, jetojnë në qytete të cilat janë klasifikuar në treshen e parë të klastërës *via-a-via*. Këtu futet vetëm 7% e popullsisë çifute.



Raporti Vjetor Për të Drejtat e Njeriut i Departamentit të Shtetit: Izraeli Nuk ndodhet në listën e shteteve që Shkëlin të Drejtat e Njeriut

Departamenti Amerikan i Shtetit publikon për çdo vit një raport vjetor ku tregon se çfarë ndodh në 196 shtete të botës, në lidhje me demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Në raportin e vitit 2006 rreth Izraelit, Departamenti i Shtetit përmendi disa raste diskriminimi. Më poshtë po ju citojmë se çfarë shkruhej në këtë raport:

-një e gjashta e fëmive arabë izraelitë ndodhen në “rrezik dhe krizë.” Studiuuesit tregojnë se niveli i varfërisë të fëmijëve arabë ishte 2.5 herë më shumë sesa tek fëmijët çifutë, dhe niveli i vdekjes së foshnjeve ishte dy herë më i lartë se foshnjeve çifute.

-Një raport i publikuar në 2005 nga Instituti i Van Leer-it të Jeruzalemit raportoi se 54% e arabëve izraelitë jetojnë nën nivelin e varfërisë në krahasim me 18% të çifutëve izraelitë. Ndërmjet komuniteteve beduine të Negev-it, niveli i varfërisë në fshatrat e njohura zyrtarisht ishte 66%, ndërsa në fshatrat jo të njohura zyrtarisht ishte 79%.

-Qeveria vuri në funksion tre sisteme të ndryshme shkollore, për fëmijët çifutë-folës, për fëmijët arabë-folës dhe për çifutët ortodoksë. Megjithatë shpenzimet e qeverisë për frymë dhe shërbimet për fëmijë në zonat arabe ishte shumë herë më të ulëta se në zonat çifute. Sipas studimit të bërë nga Universiteti Hebre në 2005, tregohet se te fëmijët çifutë ishin investuar tre herë më shumë para sesa te fëmijët arabë.

-OJQ-ja Sikkuy në raportin e vitit 2004-2005 deklaroi se numri i fëmive arabë që e linin shkollën ishte dy herë më i lartë sesa tek fëmijët çifutë. Në një raport tjetër të bërë nga një OJQ e besueshme tregohet se numri i braktisjes së shkollave nëpër shkollat arabe rezultoi të ishte tre herë më i lartë se ajo e shkollave çifute. Në shtator të 2005 ministria e Arsimit informoi Komitetin e Edukimit të Knesset-it se shkollat arabe kishin një shkurtim prej 1,800 klasash.

-Arabët izraelitë ishin të keq përfaqësuar në shumicën e universiteve, profesioneve dhe bizneseve. Nga një studim i bërë nga Universiteti Haifa dhe Organizata jo-Qeveritare Sikkuy për këtë temë në qershor, raportohet se vetëm 2,8% e punëtorëve me teknologji të lartë në vend ishin arabë. Studiuuesi i Universitetit të Haifas vëren se 70% e arabëve me diploma kolegji në fushën e teknologjisë së lartë gjatë viteve 2001-2005



nuk mundën të gjenin punë në vend.

Arabët izraelitë me edukim të lartë shpesh nuk gjejnë punë në profilin e tyre. Sipas raportit të bërë nga një Komision i Shërbimit Civil mbi përfaqësimin e arabëve në qeveri, në vitin 2004 vihet në dukje se vetëm 3 nga 809 punonjësit ishin arabë, ndërsa në Ministrinë e Jashtme 7 nga 933 punonjës ishin arabë.

.....sipas të dhënave të fundit të qeverisë vetëm 5,5% e punonjësve në shërbimin civil ishin arabë. (shumica e tyre janë të punësuar në punë dytësore. Në Ministrinë e Shëndetësisë punojnë afërsisht 56% arabë, përfshirë këtu dhe spitalet shtetërore).

Në prill media raportoi se afërsisht 1 % e punonjësve në kompanitë shtetërore ishin arabë. Pavarësisht nga çfarë u përmend më lartë, Izraeli në fund të fundit, sipas SHBA-ve është një shtet i shkëlqyer, dhe nuk klasifikohet në vendin e shteteve që shkelin të drejtën e njeriut .

► US Department of State Annual Human rights Report, në:

<http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2006/78854.htm>

Duke u bazuar në përmbajtjen e zhvillimit njerëzor të K.B., i njëjti studim na tregon se minoriteti arab është renditur i 62-ti, çka do të thotë një diferencë prej 40 gradësh nga shteti. (Ndërmjet 177 shteteve të K.B., Izraeli zuri vendin e 22-të për zhvillimin njerëzor gjatë vitit 2002). Në prodhimet e mëdha të vendit, treguesi për një çifut arrin shifrën e 19,150\$, ndërsa për një arab arrin në 6,756\$. Kjo tregon se çifutët kanë një diferencë prej tre herësh më shumë, krahasuar me arabët.²⁴

Punësimi i arabëve në shërbimet shtetërore, zë vetëm 5% të normës. Le të shohim më poshtë përqindjet e shtetasve arabë të punësuar në disa sektore të ministrive²⁵.



Tabela (1): Mesatarja e punëtorëve arabë të punësuar nëpër ministri

Ministritë	Përqindjet e arabëve të punësuar (%)
Ministria e Financës	0.4
Ministria e Industrisë dhe Tregtisë	0.7
Administrata e Tokës Izraelite	0.7
Ministria e Komunikimit	1.5
Ministria e Transportit	1.5
Ministria e Bujqësisë	2.9
Ministria e Infrastrukturës	2.8
Ministria e Turizmit	2.5
Ministria e Ndërtimit dhe e Banesave	0.8
Ministria e Mirëqënies	3.2
Ministria e Drejtësisë	3.5
Ministria e Edukimit	6.3
Ministria e Punëve të Brendshme	Më pak se 2



2. Racizmi në nivelet publike

Përveç racizmit institucional dhe atij të elitës, manifestimi i racizmit dhe

diskriminimit ndaj shtetasve arabë, vërehet gjithashtu dhe në publik, ku çifutët izraelitë, qoftë edhe si individë, e ushtrojnë në vijimësi diskriminimin ndaj arabëve. Zakonisht, arabët janë diskriminuar gjithandej, qoftë me diskriminim institucional, atij të elitës apo edhe individual. Ky është një fakt jo vetëm historik, por gjithashtu edhe një realitet i pamohueshëm. Këto lloje sentimentesh raciste, mund t'i shohim qartazi nëpërmjet ofensivës së ushtruar, me të cilën arabët përballen çdo ditë, si rezultat i ndjenjës së të tyre për kombin. Nuk mund të lemë pa përmendur mallkimet dhe vështirësitë e mëdha që hasin muslimanët dhe simbolet e tyre. Kjo gjë u shfaq shumë qartë gjatë ndeshjeve të futbollit.

Besimi dhe shprehja më e spikatur e racizmit të famshëm çifut ndaj arabëve, është reflektuar edhe në opinionin publik, i cili vërteton sjelljen dhe qëndrimet e mazhorancës së çifutëve ndaj palestinezëve. Sondazhet e kryera rreth mënyrës së sjelljes dhe studimi i opinionit publik,

...Izraeli nuk u themelua për të sjellë një regjim demokratik në një rajon të zymtë. Ai u themelua si një shtëpi kombëtare për popullin çifut... Fakti që arabët janë shtetas të shtetit çifut dhe jo shtetas të një shteti arab është një histori fatëkeqe... Si pasojë unë jam i mendimit që në shtetin e Izraelit, ndërmjet popullatës duhet të ketë gjithmonë një mazhorancë të rëndësishme çifute. Minoritetet duhet të jenë plotësisht besnike ndaj shtetit, të përmbushin të gjitha detyrimet për të gëzuar të gjitha të drejtat, siç janë druzet, disa nga beduinët dhe çerkezët.

...është tepër e thjeshtë që të evitosh diskutimin dhe të kthehesh në një demagog racist, por kjo është mënyra më e thjeshtë për të zgjidhur këtë problem...

Nëse ne mundohemi që të largohemi nga ky problem, ai do të na ndjeki gjithnjë. Prandaj është më mirë që të meremi me të nëpërmjet iniciativave tona.

► Gilad Sharon, bujk, biznesmen dhe djali i ish-kryeministrit Ariel Sharon, *Haaretz*, 25/4/2007.





zbulon se mazhoranca e çifutëve i shikon shtetasit arabë me dyshim të skajshëm, si dhe i konsideron ata një rrezik, një “kolonë e pestë”. Për më tepër, mazhoranca synon t’i heqë arabët nga pozitat administrative, ashtu si dhe nga pjesmarrja në politikë. Gjithashtu, ata mbështesin dhe përkrahin propozimin e transferimit.²⁶

Ky fakt është përmendur shumë qartë në raportet e Institutit Arab për të Drejtat e Njeriut (AIHR), ku tregohet se përqindja e çifutëve për përkrahjen e idesë së transferimit me forcë të palestinezëve ka arritur në 62%, ndërsa më shumë se 40% mbështesin aparteidin. Transferimi i popullsisë është politika që shteti çifut ndjek në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim spastrimin etnik, i cili ka filluar qysh në vitin 1948.²⁷

Kohët e fundit, është përdorur një formë e re aparteidi, ku çifutët bëjnë thirrje për ndarjen raciale nëpërmjet mureve ndarëse, në mënyrë që të ndajnë lagjet (p.sh., aty ku banojnë arabët dhe çifutët) me popullsi mikse. Kjo është një marrëveshje për një numër në ndryshim e sipër, dhe e mbushur plot e përplot me racizëm, ashtu siç e kanë pranuar edhe shumë prej tyre. Kështu, në nëntor të vitit 2002, një argjaturë e madhe u ndërtua për të ndarë fshatrat e varfëra arabe të Xhisr al-Zarka, nga qyteti fqinj Kisarja, i populluar më shumë nga çifutët. Gjithashtu, u ndërtua një mur ndarës ndërmjet lagjes së çifutëve të Ganei Dan në qytetin e al-Ramlah dhe lagjes së arabëve të Jauarishit. Një mur tjetër ndarës është ndërtuar midis lagjes së Pardes Snir të qytetit al-Lud, ku banojnë arabët, dhe asaj të Moshavës, apo të vendbanimeve të Nir Zvi.²⁸

Sondazhet e përvitshme të ndjenjës së përfutur, të sponsorizuar nga Qendra për Fushatën kundër Racizmit në Izrael, ka treguar se gjatë vitit 2006, kemi pasur një rritje të ndjenjës së urrejtjes tek çifutët kundrejt shtetasve arabë, në krahasim me atë të vitit 2005. Këtë mund ta shohim në tabelën e paraqitur më poshtë:



Tabela (2): Sondazhi i ndjenjës së çifutëve ndaj shtetasve arabë, 2005-2006

	2005	2006	Krahasimi ndërmjet viteve 2005 dhe 2006
Çfarë ndjeni kur në rrugë dëgjoni të flitet arabisht?			
Urrejtje	17.5%	30.7%	Kemi një rritje me 75%
Frikë	38.45%	49.9%	Kemi një rritje me 30%
Neveri	22.7%	31.3%	Kemi një rritje me 38%
A pranoni të jetoni në një vend të banuar nga arabë dhe çifutë?			
Nuk pranoj	67.6%	75.2%	Kemi një rritje me 11%
A dëshironi të keni shokë arabë dhe t'ju bëjnë vizita në shtëpitë tuaja?			
Unë nuk kam dëshirë të kem shokë arabë, e të më vijnë për vizitë në shtëpinë time.	45.2%	61.4%	Kemi një rritje me 36%
A dëshironi apo jo, të punoni në një vend ku përgjegjësi është arab?			
Nuk dëshirojnë	33.9%	49.9%	Kemi një rritje me 47%
A i pranoni apo jo thëniet e mëposhtme:			
E pranoj thënien që martesë ndërmjet një çifuti dhe një arabi përbën tradhëti ndaj shtetit çifut dhe popullit të tij.	39.6%	51.2%	Kemi një rritje me 29%



Pranoj thënie se duhet të ekzistojë një vijë ndarëse ndërmjet arabëve dhe çifutëve në dëfrime dhe në kompetenca.	40.6%	55.6%	Kemi një rritje me 37%
Pranoj thënie: “Arabëve duhet t’i hiqet e drejta e votës për parlamentin”.	25.6%	39.9%	Kemi një rritje me 55%
Pranoj thënie: “Arabët përbëjnë një kërcënim për sigurinë dhe demografinë e shtetit çifut”.	62.8%	56.2%	Kemi një rënie me 10%
Pranoj thënie: “Kultura arabe është më inferiore se sa kultura çifute”.	34.2%	37.8%	Kemi një rritje me 10%
Pranimi i deklaratës: “Izraeli duhet të nxisë shtetasit arabë të emigrojnë jashtë vendit”.	39.5%	50.9%	Kemi një rritje me 28%

Tabelat e mësipërme na tregojnë që ndjenja e racizmit dhe e sjelljes së çifutëve kundër shtetasve të tyre arabë është shumë e lartë, si dhe po shkon lart e më lart. Ajo që nuk e shuan ende kuriozitetin e hidhur, është fakti që gjysma(49.9%) e çifutëve kanë frikë kur dëgjojnë gjuhën arabe në rrugë, pavarësisht që ajo është gjuha e dytë zyrtare, pas asaj hebreje. Kjo është arsyeja përse 30% e urrejnë këtë gjë. Ajo që është më shokuese mbetet fakti se 75% e çifutëve nuk duan që të jetojnë në një pallat ose në “kondominume” ku banojnë arabë. Ndërsa 49.9% nuk preferojnë që të punojnë në një vend ku përgjegjës apo drejtor është një arab. Kjo tregon se kemi një rritje me 47%, që nga sondazhet e vitit 2005, për të njëjtin topik.



Banorët e Jeruzalemit jetojnë në bodrume dhe në çati të shtëpive për të ruajtur lejen e rezidencës

Në maj 2005 Salva dhe 7 fëmijë e saj u njoftuan nga autoritetet izraelite se do t'iu hiqej e drejta e rezidencës dhe e sigurimeve shëndetësore në qytetin e tyre të Jeruzalemit, për shkak se jetonin në një nga periferitë e qytetit, të cilat Izraeli i konsideron si pjesë të Bregut Perëndimor. Si pasojë Salva dhe fëmijë të saj nuk u ngelej asnjë zgjidhje tjetër përveçse të largoheshin nga shtëpia e tyre e madhe në lagjen al-Barid për në një parafingo që më parë përdorej si dyqan i vogël në një nga rrugicat e Qytetit të Vjetër (Old City) për të ruajtur rezidencën. Salva dhe fëmijë të saj janë “rezidentë” në qytetin e tyre por nuk gëzojnë të drejtat e shtetësisë ashtu siç i gëzojnë homologët e tyre çifutë sipas klasifikimit Izraelit për banorët arabë, që banojnë në Jeruzalemin lindor, pas pushtimit të tij në 1967. Banorët arabë të Jeruzalemit kanë ngritur shtëpi të thjeshta të bëra me llamarina për fëmijët e tyre të martuar në mënyrë që të ruajnë të drejtën e rezidencës.

Një avokat çifut e ka përshkruar grabitjen e shtëpive të banorëve të Jeruzalemit si një “pastrim etnik”. Avokati gjithashtu ka thënë: “Izraeli do ta boshatisë qytetin nga arabët. Për këtë arsye, ai kufizon ligjin e shtetësisë. E drejta e rezidencës i jepet atyre vetëm për një kohë të shkurtër, e cila ndryshon menjëherë nëse ata ndryshojnë adresën e tyre. Dhe nëse ata udhëtojnë për punë, Izraeli ua mohon të drejtën e residences dhe kthimin në Jeruzalem.” Avokati shton se, “izraelitët nuk ofrojnë për arabët qendra edukimi dhe nuk u sigurojnë atyre as sigurime shëndetësore, as vende të mira pune, si dhe nuk u japin leje ndërtimi. E gjitha kjo bëhet për ti detyruar ata që të emigrojnë jashtë vendit.”

► *Al-Ayyam*, Palestine, 23/6/2007.



Ndërsa 55.6% mbështesin ndarjen midis arabëve dhe çifutëve në vendet argëtuese, 39.9% janë në favor që arabëve t'u hiqet e drejta e votimit në zgjedhje. E njëjta përqindje beson se martesat midis arabëve dhe çifutëve janë një tradhëti për shtetin dhe popullsinë çifute. Ndërsa 56.2% besojnë se arabët përbëjnë kërcënim për sigurinë dhe demografinë e shtetit çifut.²⁹

Në këtë kontekst, vlen të analizohet edhe barometri për marrëdhëniet mes arabëve dhe çifutëve për vitin 2006, i kryer nga Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin e "Haifa", studim në të cilin merrnin pjesë 1423 çifutë dhe arabë. Rezultatet e studimit tregojnë se 63% e çifutëve i shmangen udhëtimeve në qytetet arabe, ndërsa 68% janë të shqetësuar për numërin e lartë të lindjeve tek arabët. Ndërsa 64% e tyre i shohin ata si një rrezik për sigurinë kombëtare.

Gjithashtu, 73% e çifutëve dyshojnë për besnikërinë e arabëve ndaj shtetit. Në të kundërt, mazhoranca e arabëve ka frikë se mos bëhen subjekt i akteve të dhunës nga çifutët, ndërsa shohim se 73% e tyre kanë frikë nga dhuna që ushtrohet nga autoritetet çifute ndaj tyre. Gjithashtu, shohim se 71.5% kanë frikë nga dhuna e ushtruar nga individët çifutë, ndërsa 60% e tyre kanë frikë se mos i përzënë nga shteti, një kërcënim apo një fakt që çifutët radikalë të krahut të djathtë, bëjnë thirrje të vazhdueshme për t'i përzënë palestinezët nga toka e tyre. Ndërsa 80% e tyre kanë frikën e shpronësimit nga shteti.³⁰

3. Racizmi në nivelet e drejtësisë

Ajo që mund të theksojmë është se diskriminimi në shtetin çifut nuk është vetëm problem i fanatizmit apo i devijacionit individual, por një çështje që bazohet në ligje dhe në karakterin sionist. Prandaj, ligjet e diskriminimit dhe racizmit përbëjnë një



pjesë organike të strukturës së ligjeve të shtetit sionist. Është ky karakter që e ndan diskriminimin racial të praktikuar prej blloqeve kolonizuese, nga pjesa tjetër e botës. Diskriminimi, në radhë të parë varet nga ligjet e vetë shtetit. Diskriminimi i praktikuar në të gjitha shtetet e tjera, bie në kundërshtim me ligjin. Ligje të tilla reflektohen në kushtet dhe situatat e jetës së arabëve, që banojnë në zonat e pushtuara para dhe pas vitit 1967, si dhe në shumë aspekte të jetës së tyre.³¹

Knesset-i ka miratuar një paketë ligjesh që shërbejnë ekskluzivisht për dominimin e mazhorancës çifute dhe hegjemoninë e tyre në Izrael, në kurriz të qytetarëve të tij arabë. Kjo është bërë nëpërmjet metodës së legalizimit të diskriminimit institucional ndaj arabëve, duke i dhënë diskriminimit racial një konstitucion të jashtëm legjitimiteti. Duke i dhënë dritë statusit ligjor për arabët e Izraelit, kjo në të vërtetë ka një rëndësi madhore dhe të veçantë. Çka përbën hyrjen kryesore në botën e tyre, si dhe një kriter të vërtetë për të gjykuar pozicionin e tyre në stukturën çifute, apo edhe në bërjen e kushtetutës. Gjithashtu, shërben për të kuptuar pozicionin ligjor dhe civil. Ajo që na ndihmon të kuptojmë edhe rëndësinë e statusit ligjor, është fakti që ajo shkon përtej faktit të kryer, të përfaqësuar nga politika e përdorur kundër arabëve, si dhe reflekton të vërtetën sipas këndvështrimit racist, që kontrollon mënyrën se si mazhoranca çifute vepron apo sillet me arabët palestinezë.

Studimi i natyrës së ligjeve që përfshijnë diskriminimin racor kundër popullsisë arabe në Izrael, zbulon se, pavarësisht nga fakti që ato prekin të gjitha sferat e jetës, synojnë që t'i shërbejnë elementëve njerëzorë dhe materialë. Dy janë elementet që lëvizja sioniste është përpjekur në mënyrë të vazhdueshme të bëjë të disponueshme, nëpërmjet inkurajimit të çifutëve, kudo që ndodhen, për të emigruar në Izrael, si dhe për të konfiskuar dhe njëkohësisht judaizuar tokën palestineze.



Për të diskutuar rreth diskriminimit ligjor kundër arabëve, kjo kërkon një studim të detajuar e të plotë, i cili tejkalon qëllimin e kësaj pune. Prandaj, në këtë kontekst, do të përpiqemi të tregojmë ligjet diskriminuuese, pa hyrë tepër në detaje.³²

a. Ligji i rikthimit dhe ligji i shtetësisë

Numri i çifutëve banues në SHBA, ka qënë gjithmonë më i lartë se sa i atyre që jetojnë në Izrael, ose thënë ndryshe në Palestinën historike (që ndodhet nën pushtimin çifut). Pavarësisht nga ky fakt, të gjithë çifutët e Amerikës, sipas ligjeve çifute, kanë të drejtën të bëhen shtetas çifutë. Kështu, që të bëhen shtetas të tillë, ata duhet të vijnë e të vendosen aty, si dhe të blejnë prona, megjithëse shumica e tyre nuk kanë dijeni fare për shtetin. Çdo çifut është i lirë për të ardhur sa herë të dojë në Izrael ose Palestinë, dhe shteti menjëherë u jep atyre shtetësinë. Ndërsa palestinezët, që janë përzënë nga tokat e tyre dhe që vazhdimisht presin në kufi, nuk mundën ta kalojnë dot kufirin për t'u kthyer rishtazi në fshatrat dhe në vendbanimet e tyre, edhe pse disa prej të cilave shihen me sy të lirë nga kufiri. Ironikisht, atyre u është ndaluar e drejta për të jetuar apo për të vizituar shtëpitë e tyre, ku ata jetonin më parë.

Literatura e politikës sioniste pretendon që Izraeli është një shtet i lirë demokratik, por natyra e sistemit të politikës sioniste ka treguar deri tani të kundërtën e saj. Ajo na ka treguar një “shtet me ideologji dominuese. Sionizmi ka përcaktuar kufinj të shtetit në një mënyrë gjeografike të papërshtatëshme, ashtu si edhe e konsideron atë si një shtet për çifutët e mbarë botës, se sa një shtet për shtetasit që banojnë në të”.³³ Akademiku çifut ka thënë se Izraeli është një shtet jo i lirë demokratik, dhe ai preferon që të përdorë termin “demokraci etnike”, për ta përshkruar atë.³⁴



Ligji i rikthimit dhe ligji i kombësisë, kanë një rëndësi të veçantë, pasi ato përbëjnë dokumentacionin ligjor për “importimin” e elementëve çifutë dhe legalizimin e prezencës së tij. Kjo vjen si rezultat i orvatjeve për të garantuar një mazhorancë çifute. Ligji i rikthimit dhe ligji i kombësisë janë të rëndësishëm, sepse ato plotësojnë njëra-tjetrën, për ngërthimin e tyre në një sistem flagrant diskriminues. Këto ligje përfshijnë akte që aktivizojnë planin për të rritur numrin e popullsisë çifute *via-a-via* dhe sistemin për uljen e popullsisë arabe, si dhe eliminimin e tyre.³⁵

Ligji i rikthimit çifut përfshin diskriminimin zhurmëmadh kundër shtetasve arabë, i cili bie në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare dhe marrëveshjen që shpreh qartësisht të drejtën e palestinezëve për t’u kthyer në vendin e tyre. Ndërmjet këtyre marrëveshjeve janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, në vitin 1965, Marrëveshja mbi Eliminimin e të gjitha llojeve të Diskriminimit Racial, në vitin 1966, Kongresi Ndërkombëtar i të Drejtës së Qytetarit dhe i Politikës, Kongresi i katërt i Gjenevës për mbrojtjen dhe mjekimin e civilëve të kapur gjatë luftës. Kjo erdhi si rrjedhojë e rezolutës 194, të Asamblesë së Përgjithshme të B.K. të vitit 1948, e cila kërkon rikthimin e refugjatëve palestinezë.³⁶

Në fakt, pikëpamjet brenda dhe jashtë shetit çifut, janë pothuajse të njëzëshme për faktin që ligji i rikthimit përmban diskriminim kundrejt arabëve. Megjithatë, kjo mospërputhje shtrihet në natyrën e justifikimit të shfaqur për zbatimin e llojeve të tyre. Megjithatë, kur shohim garancitë dhe masat që janë marrë për të mbrojtur shtetin “çifut”, konstatojmë se sa të thella janë rrënjët e diskriminimit racial.

Ndërsa ligji i rikthimit lejon çdo çifut ose të konvertuar në judaizëm - pavarësisht nga vendndodhja e tyre për të emigruar në Izrael pa kushte - të gëzojë të drejtën për të marrë nënshtetësi çifute,



ndërkohë që popullata vendase palestineze e ka të ndaluar, tragjikisht dhe ironikisht, mundësinë për të gëzuar këto të drejta. Duke ndjekur këtë politikë raciste, çifutët kanë vendosur shumë kushte, qysh kur palestinezët banonin në tokën e tyre.

Pavarësisht nga ndryshimet e shumta që u bënë në ligjin e kombësisë, më shumë diskriminues dhe racist, mbetet ndryshimi i ligjit të miratuar më 31/7/2003, që i përket martesës, ligj që të kujton ndalimin e martesës së përzier, që njëherë e njëkohë u ishte imponuar afrikano-amerikanëve në SHBA. Sipas këtij diskriminimi, palestinezëve nuk u jepet mundësia për të marrë nënshtetësinë apo rezidencën, me anën e bashkimit familjar, apo edhe përmes ribashkimit familjar të tyre në Izrael, me ata që jetojnë në territorin e sunduar nga çifutët. Kjo do të thotë që një palestinez që jeton në BP (WB) apo R.G., po të martohet me një palestineze që ka nënshtetësi çifute, bashkëshorti apo bashkëshortja nuk gëzon të drejtën e nënshtetësisë çifute, pavarësisht faktit që të dy janë palestinezë. Ky fakt nuk zbatohet në rastin kur një çifut martohet me një femër që ka kombësi të ndryshme nga ai, ose banon në një qytet tjetër të Izraelit. Ky ligj i diskriminimit të zhurmshëm racor, nxjerr më në pah sensin e rrënimimit dhe shkatërrimit, se sa atë të ribashkimit të gjithë familjes palestineze.³⁷

Në komentin e tij për këtë legjislacion krejtësisht të gabuar dhe diskriminues, avokati Gilad Kariv u shpreh: “Librat e ligjit çifut nuk kanë hasur ndonjë rrezik të qartë për të qënë të njollosur me njollat e racizmit, ashtu siç kanë bërë kryekëput me këtë ligj”.³⁸ Gjithashtu, dënimi që i bëhet këtij statuti racist nga organizatat “Amnistia Ndërkombëtare” dhe “Vëshgimi i të Drejtave të Njeriut” është evident. Pra, i kryer nga dy prej organizatave të njohura ndërkombëtare, më 27/7/2003, që i kanë dërguar një letër parlamentit çifut, duke i kërkuar anëtarëve të tij që të



hedhin poshtë ligjin racist martesor, që shkel ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Por fatkeqësisht, kërkesa e tyre u hodh kategorikisht poshtë nga Knesset-i.

b. Ligjet e tokës së konfiskuar

Në 50-vjetorin e “Nakbah” të vitit 1948, dr. Ilian Pappe, historian izraelit, e quan këtë si një spastrim etnik të palestinezëve. Palestinezët në Izrael kanë organizuar demonstrata publike, e në këto demonstrata ata mbanin parulla me emrat e vendbanimeve dhe fshatrave të tyre. Pjesë e aktivitetit të axhendës së përkujtimores, ishte vizita edhe në gërmadhat dhe mbeturinat të disa fshatrave të shkatërruara. Ata vizituan shtëpitë e tyre të shkatërruara, të cilat u kthyen në rrënoja dhe në vende të pabanueshme. Mediat kanë cituar një prej vizitorëve, që tha se ato i kishin bërë “fqinjët e shtëpive të tyre”.

Shteti çifut i ka shpërngulur me dhunë palestinezët nga shtëpitë e tyre që kanë ngelur brenda kufirit të Palestinës, si dhe i ka zhvendosur në vende të tjera. Kur ata u përpoqën të kthehen përsëri në shtëpitë e tyre të rrënuara dhe në fshatrat e shpopulluara, komandanti i forcës ushtarake në vitin 1951, i shpalli ato si zona ushtarake, e njëherazi “komandanti i ushtrisë ishte i autorizuar që të çonte urgjentisht në gjyq të gjithë ata që gjendeshin pranë këtyre vendbanimeve”.³⁹

Para se të deklarohet shteti i Izraelit, sionistët kanë patur jo më shumë se 5.5% të territorit në Palestinë⁴⁰, apo më mirë të themi shifër që nuk i kalonte 8% të territorit.⁴¹ Megjithatë, nëpërmjet konfiskimit në mënyrë të vazhdueshme të tokës dhe pronës palestineze, më shumë se 93% e truallit palestinez, ka kaluar në pronësi çifute. Gjithashtu, për të shtënë në dorë Palestinën, shteti çifut ka miratuar një paketë ligjesh, të cilat i ka përdorur si mjet kryesor për të implementuar politikën e tij raciste.



Nga llogaritjet e bëra, del se mund të jenë më shumë se 30 ligje për këtë arsye, ndër më të spikaturat janë:

1. Rregullat urgjente izraelite, viti 1945.
2. Ligji i rregullave urgjente (mbjellja e tokave të humbura), 1948.
3. Ligji i rregullave urgjente (mungesa e të zotit të pronës), 1948.
4. Ligji i pronës që i mungon i zoti, 1950.
5. Ligji i zhvillimit të autoritetit (kalimi i pronës), 1950
6. Ligji i tokës dhe i pronës, 1951.
7. Ligji i përvetësimit të tokës (miratimi i akteve dhe ai i kompensimit), 1953.
8. Ligji i Keren Kayemet Le-Israel (fondi kombëtar çifut).
9. Ligji i të drejtës mbi diçka, 1960.
10. Ligji i tokës çifute, 1960.
11. Ligji themelor: toka çifute, 1960.
12. Ligji bujqësor, 1967.
13. Ligji i tokës çifute, 1969.
14. Ligji i pyjeve, 1962.
15. Ligji i planifikimit dhe ndërtimit.

Ligjet e përmendura më sipër, kanë luajtur një rol të rëndësishëm për shpronësimin e tokës palestineze, e megjithatë, ligji më problematik është ai i pronës që i mungon i zoti. Sipas tij, 20-30% të palestinezëve që jetojnë në Izrael, janë konsideruar si “mungues aktualë”. Ky ligj i ka lejuar autoritet çifute t’i konfiskojnë tokat dhe pronat e tyre, pavarësisht se ata janë “shtetas” izraelitë. Gjithashtu, ky ligj ka lejuar dhe konfiskimin e pronave të Uakfit (Waqf-ndihma islamike).⁴²



c. Ligje të tjera raciste

Përveç ligjeve për konfiskimin e tokës, ka edhe shumë ligje të tjera, ku ekspertët e ligjeve bien dakord në konstatimin e një diskriminimi sistematik, si dhe të një racizmi institucional, kundrejt palestinezëve. Ligjet më raciste dhe më dëmtuese janë: ligjet e institucioneve kombëtare, ligjet e flamurit dhe të emblemës, ligji themelor, ligji për sigurinë kombëtare të parlamentit, ligji i kompensimit, si dhe ligji i 2001-shit, për eliminimin e të drejtës së rikthimit. Gjithashtu, shumë ligje të tjera, si dhe ligje të propozuara, janë të gjitha kundër interesave të palestinezëve që jetojnë në Izrael.⁴³

Në këtë rrjedhë ngjarjesh, në mars të vitit 1998, “Lëvizja e Drejtësisë” i ka dorëzuar një raport Komitetit ndërkombëtar për eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit racor. Ky raport u dorëzua në zyrat të B.K. të Gjenevës, si një reagim ndaj raportit zyrtar të qeverisë çifute. Raporti, ka përmendur se legjislacioni çifut ka mjaft ligje që flasin për diskriminimin dhe racizmin ndaj arabëve, qofshin ato haptazi apo fshehurazi. Gjithashtu, raporti ka përmendur 17 ligje që janë tërësisht diskriminuese, ku bëhet fjalë për të drejtat e dhuruara dhe trajtimin si të preferuar, vetëm për çifutët, ose ligje që zvogëlojnë qartësisht të drejtat e arabëve në Izrael.

Ndër këto ligje diskriminuese janë: ligji themelor, dinjiteti dhe liria e njeriut, liria ndaj sundimit (ku Izraeli paraqitet si një shtet demokratik çifut), ligji i rikthimit, statuti i kongresit botëror sionist, ligji i agjensisë çifute, ligji i flamurit dhe i emblemës, si dhe ligji për shërbimet fetare çifute.

Ligje të tjera, si ai i mungesës së të zotit të pronës, ligji nr.125 i rregullave urgjente, neni 157 i ligjit të planifikimit dhe ndërtimit. Këto ligje, në mënyrë indirekte kanë diskriminuar shtetasit arabë të Izraelit. Ato gjithashtu i kanë



krijuar shtratin e duhur strukturës ligjore për fshatrat arabe, të cilat nuk i njohin zyrtarisht.⁴⁴

Pasi Komiteti Ndërkombëtar i Racizmit dëgjoi raportin e mbajtur nga ministri i jashtëm çifut dhe ai i Qendrës së Drejtësisë rreth çështjes së palestinezëve, ai shqyrtoi pikat dhe rekomandimet e qendrës, dhe më 24/3/1998 lëshoi një komunikatë për konkluzionet e studimit për kushtet e shtetasve arabë. Në komunikatë, qendra shprehte shqetësime të thella për fenomenin e racizmit çifut ndaj shtetasve arabë, si dhe për përhapjen në mënyrë sistematike të ligjit diskriminues dhe institucional kundër arabëve.⁴⁵ Qendra gjithashtu ka deklaruar që Izraeli është një shtet që nuk zbaton rregullat ndërkombëtare dhe parimet ku mbështetet statusi ndërkombëtar lidhur me këtë çështje. Gjithashtu, Komiteti Ndërkombëtar, pasi shprehu keqardhjen e tij, tha se “jo gjithmonë bisedimet ndërmjet delegacionit çifut dhe komitetit janë frytdhënëse”. Më tej, deklaroi gjithashtu se “Izraeli duhet t’i rregullojë ligjet e tij dhe t’i mbushë boshllëqet ligjore, që i ndajnë si me thikë arabët dhe çifutët në shumë sfera të jetës”.⁴⁶

Më 12/7/1998, Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore (CESCR) dënoi ashpër Izraelin për përkufizimin që ai i bën vetes, si një “shtet çifut”. Komiteti ka deklaruar se ky përkufizim nxit diskriminimin dhe i bën shtetasit jo-çifutë të ndihen inferiorë, apo si shtetas të dorës së dytë. Për më tepër, komiteti gjithashtu ka dënuar ligjin e rikthimit, si dhe ka shprehur një shqetësim të thellë për kushtet e mjeruara të jetesës së beduinëve.⁴⁷

Në një raport të përgatitur dhe të shfaqur në parlament nga shoqata e të Drejtave të Qytetarëve në Izrael, u deklarua se Izraeli nuk i përkrash standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Sipas këtij vështrimi, në raport është përmendur ekzistenca e një morie aktesh të diskriminimit



Një grua palestineze me vajzën e vogël të saj qëndron ulur mbi rrënojat që pak më parë ishte shtëpia e saj në Jeruzalemin Lindor. Ky akt u krye nga autoritetet me pretekstin se nuk kishin leje ndërtimi. Në një raport të lëshuar nga Instituti Ndërkombëtar Al-Quds, tregohet se autoritetet pushtuese në 2007 kanë shkatërruar 700 shtëpi, dhe në listë gjendeshin dhe 12 mijë shtëpi të tjera që do të shkatërroheshin në çdo moment.

► AFP, 23/11/2001.



racor, veçanërisht ndaj arabëve.⁴⁸ Në fillim të shtatorit të vitit 1999, Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, publikoi raportin e tij të parë mbi lirinë e ushtrimit të profesionit të fesë në botë. Ky raport përfshinte një kapitull të tërë për politikën e ndjekur nga shteti çifut, duke e dënuar ashpër diskriminimin që ka ushtruar ndaj shtetasve të tij arabë. Raporti përmendte që arabët hasin shumë lloje të diskriminimit në sfera të ndryshme, si në ato të edukimit, akomodimit, si dhe të shërbimeve sociale. Kjo vjen si pasojë e buxhetit të ministrisë dhe të disa ligjeve, ku këtu mund të përmendim tipikisht ligjin e rikthimit.⁴⁹

4. Racizmi në dhënien e dënimeve dhe gjykimeve

Diskriminimi racor i çifutëve ndaj arabëve, manifestohet qartazi tek ligjet dhe legjislacioni i tyre racist. Këtë diskriminim mund ta gjejmë gjithashtu në ligjin e kriminalitetit dhe të jurisprudencës çifute. Në këtë ligj, diskriminimi racor triumfon në dhënien dhe në ekzekutimin e dënimit apo të gjykimit për arabët. Kur *al-Aqsa Intifadah* filloi të përhapej, duke marrë parasysh përmasat e sigurisë që janë marrë për të mbajtur nën fre operacionet e “vetë-flijimit”*, disa prej këtyre ligjeve diskriminuese iu kanë kaluar taksistëve, që transportojnë vetëflijuesit e fshehtë dhe luftëtarët (me dijen apo me pavetëdijen e tyre) nën akuzën e “transportimit të terroristëve nga BP(WB) për në Izrael, për të kryer sulme me bomba”. Për këtë arsye, janë shqyrtuar pesë dosje të taksistëve. Katër prej tyre ishin arabë, ndërsa njëri prej tyre rezultoi çifut. Nga ky hetim i kryer, rezultoi se asnjëri prej tyre nuk e njihte identitetin e vërtetë të pasagjerëve që ata kishin transportuar. Megjithatë, prokurorët hodhën poshtë pretendimet e të akuzuarve, ndërsa dënimi për arabët u

*



dha në këtë mënyrë: Khalid Ashur dhe Sa'id Sulejmani u dënuan me 15 vjetë heqje lirie, Mahmud Naxhi u dënua me 12 vjet heqje lirie, kurse Ahmed Xhabir me 10 vjet heqje lirie.

Ndërsa për taksistin çiftut Ofer Shfatzboim, prokurorët ndryshuan akuzën, nga “kontribut në vrasje”, në “vrasje pa paramendim”. Dënimi sipas ligjit çiftut për Ofer-in ishte 6 vjet heqje lirie, dënim i cili nuk zgjati më shumë se 6 muaj. Kjo tregon se diskriminimi i dënimit është rritur 20-30 herë.⁵⁰

Shembuj të incidenteve të tilla në prokurori, ka pasur me bollëk. Këtu, po përmendim vetëm dy ngjarje: e para i ndodhi dy palestinezëve ndërsa tjetra, një banori çiftut. Ngjarja e dy palestinezëve ka ndodhur në fillim të vitit 2007, kur ata u ndoqën penalisht në Gjykatën Qendrore të Birshibas. Atje, u akuzuan për sulm me gurë ndaj një makine, si dhe thyerjen e xhamit të përparmë të saj. Megjithëse nuk kishte patur të plagosur, Gjykata, duke e ditur se këta të rinj nuk e kishin mbushur ende moshën madhore, në vend që të ishte më tolerante me ta, vendosi t'i dënonte me 5 vjet heqje lirie.

Ngjarja e dytë i përket një individi çiftut, i cili sulmoi makinën e një palestinezi, duke e plagosur rëndë. Ai nuk u ngop me kaq, i shkoi pranë dhe filloi ta godiste me grushta, pavarësisht se aty ndodheshin edhe forcat e policisë. Gjyqi i tij u zhvillua në Tel Aviv. Dënimi që dha gjykata ishte “detyrim që të punonte për mirëqënie publike”.⁵¹

Këto ngjarje nuk përfaqësojnë vetëm dy raste të ndryshme në juridiksionin çiftut ndaj popullatës palestineze, por ato janë vetëm disa shembuj flagrantë, që tregojnë se sa rrënjë të thella ka diskriminimi i zbatuar nga vetë juridiksioni çiftut.



Në fakt, janë bërë shumë studime dhe pyetësorë që e konfirmojnë këtë gjë. Ndërmjet këtyre konstatimeve është dhe studimi akademik i bërë nga dr. Hagit Turgeman, pedagog në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tel Avivit. Studimi përfshinte 1200 çështje krimesh të gjykuara, në dy gjyqet qendrore të Nazaretit dhe të Haifës. Studiuesi shqyrtoi rastet e vendimit të dhënies së dënimit, që trupi gjykues u dha arabëve dhe çifutëve, për të njëjtën vepër penale, me apo pa dosje kriminale.

Studimi përmend rastin e një çifuti që u dënua, pasi kishte sulmuar një arab. Padiësi në këtë rast ishte arab. Shanset për ta çuar çifutin në burg ishin vetëm 14% (sipas anketimeve). N.q.s. i padiësi është çifut dhe i padituri është po çifut, shansi për ta dënuar me heqje lirie është 40%. N.q.s. të dy janë arabë, atëherë shansi për të shkuar në burg është 46%. N.q.s. i pandehuri është arab dhe viktima është çifut, shansi për të shkuar në burg nga Gjykata është 77%.⁵²

Tabela (3): Dënimi me burgim sipas rastit të të pandehurit dhe të viktimës në shtetin çifut.

I dënuari	Viktima	Përqindja e të dënuarve me burgim (%)
çifut	arab	14
çifut	çifut	40
arab	arab	46
arab	çifut	77



Një fakt tjetër i rëndësishëm për të përmendur këtu është edhe burgu apo faciliteti nr. 1391, i cili u zbulua nga historiani çifut Gad Kroizer (burgu ka ekzistuar që prej mandatit britanik të Palestinës). Ky facilitet është përdorur për shumë vjet si një burg sekret, për të mbajtur të fshehur disa prej të burgosurve palestinezë, për të cilët ishte thënë se “ishin në hënë”, apo në një vend tepër të largët..⁵³

5. Racizmi në edukim

Diskriminimi në fushën e edukimit ndaj palestinezëve është reflektuar qartë në mësimdhënien si dhe në kurrikulumin e edukimit. Mund të jetë e vështirë për të nxjerrë në pah ligjet që themeluan qartësisht diskriminimin dhe se si diskriminimi i këtyre ligjeve është kaluar në mënyrë të tërthortë apo edhe të shtrembër. Një shembull i tillë është rasti me rregulloren “akademike” të botuar nga Fakulteti i Mjeksisë në Universitetin e Tel Avivit.

Këtu, kanë përcaktuar që mosha e regjistrimit për në Fakultetin e Mjeksisë duhet të jetë mbi 20 vjeç. Ngasja e tyre apo preteksti për këtë urdhëresë, është se ata e shohin të rëndësishme që studentët “të arrijnë moshën e pjekurisë dhe të jenë plotësisht të zhvilluar shoqërisht e psikologjisht, por kjo vlen vetëm për ata që zgjedhin mjekësinë si profesion”. Pavarësisht nga përpjekjet dëshpëruese për të manipuluar dhe për t’i fshehur ato, duket qartë se ata që dëmtohen më shumë nga kjo urdhëresë, janë studentët arabë, të cilët pas mbarimit të shkollës së mesme, nuk kanë të drejtën për të shërbyer në ushtrinë çifute. Kështu që, ata hyjnë në universitete qysh në moshën 18 vjeç, ashtu si ka qenë qysh prej vitit 1950. Kjo urdhëresë, në mënyrë të natyrshme, e ul kuotën e studentëve arabë për t’u regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë. Totali i numrit të studentëve arabë në këtë fakultet është 4.4%, numër shumë i vogël në krahasim me atë të shtetasve arabë, që përbëjnë 19.7% të popullsisë në Izrael. Ky rregull nuk u jep zgjidhje tjetër, veçse



të detyrohen të lenë vendin e tyre dhe të shkojnë për të studjuar në universitetet e Jordanisë apo të Europës.⁵⁴

Praktikimi i këtyre ligjeve, të cilat shfaqen kështu papritur, janë zakonisht shkaku kryesor i rënies së nivelit të edukimit dhe arsimimit për shtetasit arabë. Pra, përqindja e studentëve arabë në universitete është 8%, çka do të thotë se është më e vogël se përqindja e gjysmës së popullsisë së tyre. Ndërsa, përqindja e profesorëve arabë në universitete është 1.2%, kurse rroga mesatare e tyre është 6000 shekel (1360\$), ndërsa rroga mesatar *vis-à-vis* për akademikët çifutë është 9000 shekel⁵⁵. (1 dollar = 4.4 Shekel)

Më 12/2/2006, doli një raport statistikor për shkollat, ku përmendej se Izraeli ndjek një politikë të qartë diskriminuese ndërmjet studentëve palestinezë dhe atyre çifutë. Kjo politikë raciste është përdorur për ta thelluar hendekun mes studentëve arabë dhe atyre çifutë. Gjithashtu, raporti përmendte se në sistemin e edukimit palestinez, ka mangësi të theksuara, dhe se ekzistojnë gjithsej pesë mijë klasa, kurse numëri i shkollave fillore është 454, ndërsa ai i shkollave përgatitore, 185.⁵⁶

Kurrikula e sistemit arsimor

Konstatohet se tekstet shkollore që përdorin nxënësit çifutë janë bërë një udhëzues për të gjitha lëndët, si dhe zgjidhje për të gjitha problemet e shfaqura nga anëtarët e lëvizjes sioniste. Në thelb të listës së këtyre problemeve janë sundimi, vendbanimi, emigrimi, transferimi, dhe përzënia me dhunë e popullatës jo-çifute, apo palestinezëve dhe vëllezërve të tyre arabë. Në fakt, po të shikojmë shembujt e teksteve shkollore, të gjithë kanë mundësi të dallojnë këtë drejtim apo orientim, dhe se si ato i formojnë çifutët e rinj, duke krijuar brenda tyre një lloj motivimi themelor për antagonizmin, sundimin ushtarak të tokës apo dhe plaçkitjen e saj.⁵⁷



Në këtë kontekst, është mëse e mjaftueshme për të analizuar konkluzionet që dr. Eli Podeh ka nxjerrë nga studimi i këtyre teksteve shkollore. Në këtë studim, evidentohet se tekstet shkollore çifute janë shkaku kryesor për

formimin e ideve të paramenduara për palestinezët, të përshkruara gjerësisht. Kjo studiuese, ka renditur në listë 12 tregime që shërbejnë si momente kyçe në indoktrinimin edukativ, si dhe në procesin e formimit të autorizuar e të njohur nga çifutët, në tekstet e tyre të historisë. Studiuësja e bazon studimin në tekste, fotografi dhe karikatura, që zbulojnë se si historia është manipuluar, si një subjekt për t'i shërbyer politikës çifute, në një mënyrë të tillë që i bën shembuj domethënës për të zbuluar se sa të thella i ka rrënjët ky vështrim racist ndaj arabëve.

Një prej këtyre tregimeve titullohet “Vjeshta e gjelbër”, që tregon historinë e një plakut palestinez, i cili u arrestua nga ushtarët çifutë. Tregimi e përshkruan karakterin e plakut të zënë rob, si të dobët e frikacak. Si dikë që tregon sekretet e shtetit të tij, pa pyetur fare. Dhe këtë e bën ngaqë ka frikë, duke këmbëngulur për t'i rënë në gjunjë ushtarëve çifutë, edhe pse ata e refuzojnë këtë veprim. Në

Letra e Fëmive për Ushtarët në Izrael: “Të dashur Ushtarë, Ju lutem të vrisni sa më shumë arabë”

Më 7.5.2002, gazeta Yedioth Ahronoth publikoi disa fragmente të shkëputura nga letrat e nxënësve izraelitw që u kishin çuar ushtarëve sëbashku me disa dhurata, të cilët atëherë ndodheshin me shërbim në Ramallah. Ushtarët ishin “befasuar” nga përmbajtja e tyre në të cilat shkruhej:

-“Unë lutem për ju që të ktheheni shëndoshw e mirë në shtëpi dhe të paktën të vrisni 10 për mua.”

-“Mos ju bindni urdhërave dhe shfarrosini ata. Dhe kujtoni që arab i mirë është ai i vdekur.”

-“Lërimi palestinezët, qw Zoti ua nxiftw emrin dhe i kalbtë në zjarr. Mbushuani trupat me plumbat e M16 dhe hidhini në erë me bomba.”

► Gazeta Yedioth Ahronoth, 7/5/2002.



fund të tregimit, thuhet se ushtarët çifutë e tërheqin zvarrë të burgosurin, duke e qëlluar me armë, si dhe duke i lëshuar qentë pas tij. Në fund, një minë shpërthen dhe plaku vdes. Mina shpërtheu përpara se ushtarët të përgatiteshin ta digjinin trupin e plakut.

Në një tregim tjetër të titulluar “Pëlhura e kufirit”, tregohet për një çifut që këshillon një tjetër çifut: “Arabët janë si qentë. Nëse ata të shohin të shqetësuar, mos reago ndaj provokimeve të tyre. Vetëm kështu shmangen sulmet e tyre ndaj teje. E nëse ti vendos t’i qëllosh, ata do ikin me vrap, ashtu siç bëjnë qentë”!⁵⁸

Gjithashtu, studiuesi çifut Jeshia Horim shprehet se duke ia ngulitur në mendje që në moshë të vogël stereotipin e një arabi, i bën këta fëmijë që të shndërrohen në ekstremistë. Një studim i kryer për arabët, për ekzistencën e tyre në Palestinë dhe marrëdhëniet me ta - ku merrnin pjesë 600 çifutë izraelitë të moshës nga 15 deri në 18 vjeç – doli në përfundime të tilla :

- **92% e pjesëmarrësve mendojnë se çifutët kanë të drejta të plota në Palestinë.**
- **50% e tyre mendon se është e nevojshme që t’i mbajnë të drejtat financiare të arabëve në Palestinë, në kufirin e minimumit të mundshëm.**
- **56% refuzon në mënyrë kategorike që të kenë të drejta të barabarta me arabët, ndërsa 37% duan që arabët të jenë të barabartë me ta vetëm në shërbimet ushtarake.**
- **40% e tyre shprehën mbështetjen e tyre për çdo lëvizje të organizatave të fshehta që hakmerren ndaj arabëve.**
- **60% janë dakort që t’i përzenë palestinezët nga Palestina.**

Studiuesi çifut Adir Kohen, ka shkruar në librin e tij: “Një fytyrë e shëmtuar në pasqyrë, ky edukim racist dhe indoktrinimi që ata i bëjnë fëmijëve që në moshë të vogël, është një mënyrë që t’u formojnë atyre



një stereotip të tillë. Ky stereotip është më shumë një çështje e ujdalur nga studiuuesit çifutë në kurrikulumin e edukimit.

Gjithashtu Kohen, në një prej kapitujve të librit të tij, është fokusuar në konkluzionet e studimit që ai ka bërë me nxënësit çifutë të klasës së 4-ët dhe të 6-të të shkollës fillore të Haifës. Nxënësve u janë bërë 5 pyetje, ku disa prej ishin: “Si sillen ata me arabët, çfarë mendimi kanë për ta, dhe si i afrohen atyre?”. Rezultatet janë sa tronditëse aq edhe shqetësuese:

- **75% e fëmijëve i përshkruajnë arabët si vrasës, si rrëmbyes fëmijësh, kriminelë dhe terroristë.**
- **80% thanë se i vlerësojnë arabët si pisanjosë dhe me fytyrë të frikshme.**
- **90% deklaruan se palestinezët nuk kanë të drejtë të jetojnë në Izrael e Palestinë.**

Kohen gjithashtu ka studiuar 1700 libra fëmijësh çifutë, të publikuara në vitin 1967. Ai konstaton se 520 libra përmbanin përbuzje dhe përshkrime përkeqësuese për palestinezët. Ai u përpoq të analizojë këto përshkrime dhe konstatoi: 66% të 520 librave i përshkruajnë arabët si të dhunshëm, 52% si të këqinj, 37% si gënjeshtarë, 31% si nepsqarë, 28% si dyfytyrësh, 27% si tradhëtarë, etj. Kohen tregon se autorët e këtyre librave për fëmijë u injektojnë atyre një urrejtje të madhe ndaj arabëve, në mënyrë që t’i zhveshin nga natyra njerëzore dhe t’i klasifikojnë si një kategori tjetër njerëzish.⁵⁹

Gjithashtu, në një studim të kryer nga Universiteti i Haifës, vërehet se këndvështrimi apo mënyra se si studentët çifutë i shikojnë homologët e tyre arabë, është raciste dhe e ndërtuar në stereotip. Studimi nxjerr në pah se 75% e çifutëve i perceptojnë arabët si të pashkolluar, të pacivilizuar, pisanjosë, të dhunshëm, etj.⁶⁰



Fëmitë e Izraelit

Fëmitë izraelitë duke shkruar në predhat e artilerive, që do të përdoren për të bombarduar Libanin, gjatë luftës izraelite kundër Libanit në verën e 2006. Kjo luftë zgjati 33 ditë. Në atë mbetën të vdekur më shumë se një mijë civilë libanezë, 400 prej së cilëve ishin nën moshën 12 vjeç.

► AFP, 17/7/2007.



Kapitulli 4: Transferimi i arabëve palestinezë nga Palestina

Në qershor të vitit 1938, David Ben Gurion, ndërsa po i drejtohej Komitetit Ekzekutiv të Agjencisë Çifute për Izraelin tha: “Unë e miratoj transferimin e detyrueshëm të arabëve, dhe nuk shoh asgjë të pamoralshme në të”.⁶¹

Më shumë se 30 masakra të dokumentuara, 530 fshatra palestineze dhe vendbanime të shpopulluara e të rrënuara. Nën komandë, të drejtuar si nga komandantët ashtu dhe nga ushatarët e civilët, rreth 800.000 palestinezë janë përzënë me dhunë e barbarisht nga trojet e tyre gjatë vitit 1948. Ishte ky barbarizëm që i detyroi palestinezët t’i drejtoheshin diasporës. Refugjatët palestinezë i mbajnë akoma sot e kësaj dite çelësat e shtëpive të tyre me vete, si dhe këmbëngulin ende në të drejtën e rikthimit në trojet e tyre.



ILAN PAPPE
The **ETHNIC
CLEANSING** of
PALESTINE

'Ilan Pappé is Israel's bravest, most principled,
most incisive historian.'

JOHN PILGER



....Dhe akoma një krim i tillë është fshirë pothuajse plotësisht nga kujtesa e publikut global: dëbimi i palestinezëve në 1948 nga Izraeli. Kjo, që është ngjarja më e rëndësishme e historisë moderne të tokave të Palestinës, është mohuar në mënyrë sistematike që atëhere dhe deri më sot nuk njihet si një fakt historik, të mos përmendim këtu që ajo është një krim me të cilin duhet të përballemi politikisht dhe moralisht.

Përrallat historiografike izraelite flasin për një “transferim vullnetar” dhe masivë të disa qindra e mijëra palestinezëve të cilët vendosën të largohen nga shtëpitë dhe fshatërat e tyre përkohësisht në mënyrë që ti hapnin rrugë ushtrive pushtuese arabe të cilat kërkonin të shkatëronin shtetin çifut.

Nuk kam pikë dyshimi se mungesa deri tani e paradigmës së pastrimit etnik është pjesë e arsyes pse mohimi i katastrofës mundi të vazdonte kaq gjatë . Kur lëvizja sioniste krijoi shtetin e saj kombëtar, ajo nuk bëri një luftë nëpërmjet së cilës “tragjikisht por pashmangshmërisht” çoi në dëbimin e “disa pjesëve” të popullatës

vendase, por në të kundër: qëllimi kryesor i saj ishte pastrimi etnik i Palestinës të cilin, lëvizja e kërkonte për shtetin e saj të ri.

....kjo në të vërtetë është akuza ime kundër politikanëve të cilët kurdisën, dhe gjeneralëve të cilët e bënë këtë pastrim etnik. Tani që përmend emrat e tyre, nuk e bëj sepse dua që ti shoh ata të gjykuar pas vdekjes, por në mënyrë që të humanizojmë shkaktarët si dhe viktimat: dua që të ndaloj krimet që Izraeli ka kryer, të cilat shpesh justifikohen duke përdorur justifikime qesharake si psh. ‘rrethanat,’ ‘ushtria,’ apo siç Morris thotë, ‘ a la guerrew comme a la guerre,’ (në luftë si në luftë) dhe togëfjalësha të tjerë të paqartë të cilët justifikojnë shtetin sovran dhe i mundësojnë individëve ti shpëtojnë drejtësisë.

....’Të huajtë,’ thonë në vendin tim, ‘nuk dhe s’ mund ta kuptojnë këtë histori të ndërlikuar’ dhe si pasojë nuk është e nevojshme ta shpjegojmë një gjë të këtillë.

E gjitha që dikush mund të bëjë, ashtu siç dhe qeveria izraelite ka mësuar ti thotë botës me vite me radhë, është që të na lejojë “ne”, izraelitët, si përfaqësues të “civilizuar” dhe “racionalë” në këtë konflikt, që të gjejmë zgjidhjen e duhur për “vetet tona” ndërsa sa për anën tjetër, palestinezët ata mund të shihen si “të pacivilizuar” dhe “emocionale” ashtu siç shihet e gjithë bota arabe ku edhe Palestina bën pjesë.

Por historia e 1948-ës, sigurisht, nuk është aspak e komplikuar... Ajo është e thjeshtë. Është një histori e tmerrshme e një pastrimi etnik në Palestinë, një krim kundër njerëzimit që Izraeli do që të mohojë dhe të bëjë botën ta harrojë.

► Ilan Pappé, *The Ethnic Cleansing of Palestine* (Oxford: OneWorld Publications, 2006).



Ideja e transferimit, një term eufemistik për shpërnguljen dhe dëbimin me dhunë të palestinezëve nga trojet e tyre, është mjaft e zakonshme në shtetin çifut, që akoma vazhdon të përhapet e të përkrahet sot e kësaj dite nga çifutët. Ky koncept bazohet katërcipërisht në sionizëm. Një rrënjosje e tillë sioniste në mentalitetin e tyre, e sheh tokën e shtetit si një të drejtë të trashëguar për çifutët dhe që i përket eskuzivisht atyre.

Një vështrim i tillë i ka çuar sionistët në “ekstrapolim”, se arabët janë të huaj, nuk i përkasin këtij vendi, si dhe duhet të transferohen ose duhen përzënë një orë e më parë. Kështu, ideja e transferimit të popullsisë arabe ka qenë gjithmonë pjesë e projektit sionist në të gjitha etapat e tij, para dhe pas themelimit të shtetit të tyre. Shumë sionistë izraelitë i përdorin dhe i shpërdorin librat e fesë, si një pretekst për përndjekjen e palestinezëve, ashtu siç tregohet edhe në fragmentet e mëposhtme:

“megjithatë në qytetet e kombeve Zoti juaj ju jep juve si trashëgimi, që të mos lini në jetë asgjë që merr frymë.”

“shkatërrojini ata plotësisht- Hittites, Cannanites, Amorites, Perizites, Hivites, dhe Jebusites- ashtu siç ju ka urdhëruar Zoti juaj.”⁶²

“Dhe kur Zoti t’i sjellë ata përpara jush, ju duhet t’i shtypni ata dhe t’i shkatërroni plotësisht, e mos bëni marrëveshje me ta, dhe mos shfaqni ndonjë mëshirë për ta...”⁶³

Thirrjet e transferimit apo shpërnguljes së arabëve nga Palestina, i gjejmë qysh në shkrimet e hershme të sionizmit. Këto thirrje janë përkrahur dhe propaganduar nga udhëheqësit e mirënjohur dhe themeluesit e sionizmit, siç është edhe Izrael Zangvill, i cili punoi në përhapjen e motos së shprehur nga lordi britanik Shaftesbury: “Një tokë pa popull, për një popull pa tokë,”⁶⁴.



Ndërsa meditonin për transformimin e shoqërisë çifute në një shtet, Herzl më 12/6/1895 shkruan në ditarin e tij:

“Ne duhet t’i shpronësojmë butësisht. Pronat private në kadastra do të na caktohen neve... Ne duhet të përpiqemi të përçojmë e frymëzojmë pesimizëm te popullata vendase, që të largohen jashtë vendit, duke u siguruar atyre punësim në shtetet kalimtare, ndërsa ne nuk do të lejojmë punësimin e tyre në shtetin tonë... Proçesi i shpronësimit dhe i shpërnguljes së të varfërve duhet bërë me shumë maturi dhe me kujdes të veçantë”.⁶⁵

“Në Palestinë ne nuk do të propozojmë që të shkojmë pas konsultave dhe dëshirave të banorëve të vendit.... Të Katër Fuqitë e Mëdha janë të vendosura ndaj sionizmit. Dhe sionizmi qoftë drejt apo gabim, i mirë apo i keq, është i rrënjësor në traditën shekullore, në nevojat e sotme, në shpresat e së ardhmes, të cilat janë shumë herë më të rëndësishme sesa dëshirat dhe paragjykimet e 700 mijë arabëve që tani banojnë në atë tokë të lashtë.”

➤ Shkëputur nga një memorandum i Sekretarit të Jashtëm Britanik Balfour dërguar Lord Curzon më 11.8.1919. Ky memorandum mbahet në British National Archives, Public Record Office, F.O. 371/4183.

Gjenden dëshmi të mjaftueshme për të argumentuar idenë e transferimit apo e largimit të palestinezëve nga toka e tyre, si zgjidhja e duhur e problemit sionist. Një shtet ku zenë vend mendësi të tilla, është më shumë se sa një pellg idesh të përgatitura nga themeluesit e sionizmit. Megjithatë, janë mëse të kuptueshme punët e kujdesshme dhe fushatat sistematike, apo planet e bëra prej këtyre themeluesve për të ardhmen. Kuptohen gjithashtu programet praktike për vendbanimet, të diskutuara e miratuara nëpër takimet e fshehta të komitetit të lëvizjes sioniste. Këto takime, jo vetëm përfshijnë Herzl dhe Zand, por gjithashtu miq të figurave të tjera të njohura siç janë Leon Motzkin, Nachman Syrkin, Nahum Sokolow, Arthur Ruppin, Berl Katzennelson, Menachem Ussishkin, Victor Jacobson, Chaim Weizmann,




Aharon Ahronson, Ze'ev Jabotinsky, Abraham Granovsky, David Ben Gurion, Yitzhak Ben-Zvi, etj. Në realitet, këta themelues planifikonin për të çrrënjësuar palestinezët, për t'i transferuar në mënyrë sistematike e për t'i vendosur në shtetet fqinje, në mënyrë të tillë që të përgatiteshin për zbatimin e projektit sionist. Këta themelues, i përkasin një aradhe të gjatë të grupit të politikanëve sionistë.⁶⁶

Gjithashtu, Benny Morris beson se udhëheqja sioniste, nga fundi i vitit 1930 dhe në fillim të vitit 1940 - thuhet konsensualisht dhe bindshëm- përkrahu idenë e “transferimit” në mënyrë vullnetare apo të detyrueshme, si një zgjidhje e çështjes arabe. Ai gjithashtu shtoi se gjenden dëshmi të shumta e të qarta, për të përkrahur këtë besim.⁶⁷

Gjithashtu, gjatë mandatit britanik të Palestinës, udhëheqësit sionistë vareshin nga një politikë që u mundësoi atyre të zgjeronin më tej marrëdhëniet ekzistuese me britanikët. Kështu, ata ranë dakord me oficerët britanikë, në mënyrë që të arrinin një zgjidhje të “problemit të popullsisë arabe” në Palestinë, duke i transferuar ata në shtetet arabe. Evidenca e këtyre komunikimeve private me oficerët e posteve të larta, me burra shteti të njohur, si dhe rishikimi që i bëri Winston Churchill çështjes palestineze, në tetor të 1919-ës, përmendte që britanikët u kanë bërë një premtim çifutëve për t'i vendosur ata në Palestinë. Ashtu si dhe tentativa e çifutëve për të evakuar banorët vendas, gjeti aprovimin e përmbushjes së e kërkesave të tyre, si një çështje e zgjidhur.⁶⁸

E njëjta politikë u ndoq edhe nga presidenti i Organizatës Botërore Sioniste Chaim Weizmann, i cili dëshironte të bënte një hap përpara në realizimin e projektit sionist, duke formuluar një zgjidhje radikale për dy probleme: atë të “tokës” dhe atë “të popullsisë arabe”. Prandaj, ai sugjeroi një plan përkrahës për transferimin e popullsisë arabe. Plani i tij iu bë prezent Zyrës Koloniale Britanike. Ajo sugjeroi që duhej të



Në një takim të zhvilluar me dyer të mbyllura me ambasadorin Sovietik në Londër Ivan Maisky, në shkurt të 1941, Chaim Weizmann i propozoi atij transferimin e një milion palestinezëve nga toka e tyre në mënyrë që ti zëvendësonte ata me 4-5 milion çifutë nga Evropa Lindore. Për këtë ambasadori dërgoi një raport që është mbajtur në arkivat e ministrisë së Jashtme të Rusisë, i cili u zbulua nga gazeta izraelite Yedioth Ahronoth në maj 1993. Ky raport u publikua nga gazeta Al-Quds dhe jordanezja Alrai më 29.5.1993.

- Weizmann është një udhëheqës sionist, Presidenti i Organizatës Botërore Sioniste (1921-1933, 1935-1946), dhe presidenti i parë i Izraelit.



përfshihej një hua apo një borxh prej një milion paund palestinezë, që do të grumbulloheshin nga manjatët dhe biznesmenët çifutë, në mënyrë që të risistemoheshin të transferuarit apo grupet e fshatarëve arabë, të cilët do të shpërnguleshin në Transjordan.⁶⁹

Në këtë kontekst, David Ben Gurion, në tetor të vitit 1937, i shkruan djalit të tij: “ Ne duhet t’i përzëmë arabët dhe të zëmë vendin e tyre... kështu ne do të kemi fuqi në vendimet tona”.⁷⁰ Çështja e përzënies së arabëve, ishte një pikë shumë e rëndësishme në axhendën e kongresit ndërkombëtar të “Ichud Poalei Tziyon”, komisioni më i lartë në lëvizjen punëtore sioniste. Kjo çështje ishte gjithashtu tepër e rëndësishme, ndërmjet çështjeve të bëra prezente në axhendën e 20-të të Kongresit Sionist. Të dyja këto kongrese u mbajtën në gusht të vitit 1937, në Zyrih. Mazhoranca e delegacionit të njohur dhe pjesmarrësit në të, shprehën përkrahjen e tyre, si dhe aprovuan idenë e transferimit të tyre.⁷¹

Mes viteve 1934 dhe 1948, një numër i konsiderueshëm planesh sioniste të transferimit, ishin orkestruar dhe shfaqur në terren, si: plani i detyruar i transferimit të Sokins (1937), plani i transferimit të Weitz (dhjetor 1937), plani i Bonnet (korrik 1938), plani i Ruppin (1938), plani al-Jazirah (1938-1942), plani për të transferuar arabët nga Palestina në Irak nga Edward Norman (1934-1948), plani i Ben-Horin (1933-1938), dhe i fundit, por jo i pakët nga rëndësia, plani për transferimin me forcë, i Joseph Schechtman (1948). Gjatë kësaj kohe tre “Komitetet e Transferimit”, vepruan në mënyrë të tillë, që të diskutonin e të hartonin praktikisht avancimin e planeve të transferimit.⁷²

Këto plane dhe projekte na tregojnë se problemi i refugjatëve palestinezë nuk është ashtu rastësor apo i paplanifikuar, por rezultat i planit dhe orkestrimit të paramenduar. Transformimi demografik, etnik dhe fetar i palestinezëve, i karakterizuar nga “transferimi” i një numëri sa



Pastrim i Fshehtë Etnik

Shkatërrimi i mbi 40 fshatrave arabe të panjohura zyrtarisht nga Izraeli në Negev.

“Po flas për më shumë se 140 mijë arabë që jetonin në Negev i cili ndodhet në pjesën jugore të Palestinës. Këta banues në literaturë njihen si arabët e Beershebas apo beduinët e Negevit. Këta janë pasardhësit e beduinëve të cilët janë vendosur me mijëra vjet më parë në Negev. Ata u bënë pronarët e këtyre trojeve, të cilat në 1948 kishin rreth pesë milion dynym tokë (një dynym është i barabartë me 1000 m katror apo 0,25 akër). Prej këtyre pesë milion dynymëve banorët e kishin zakon që dy milion dynymë ti kultivonin sipas sezonit të shirave. Megjithatë pas pushtimit masiv izraelit në 1948, Negevi u evakua nga pjesa më e madhe e popullsisë së tij (ndërmjet 80 dhe 85%). Vetëm 11 mijë kanë ngelur në tokën e tyre dhe refuzojnë që të largohen nga ajo. Pas shumë vitesh, numri i vogël i popullsisë së ngelur është rritur dhe tani arrin 140 mijë (gjysma e të cilëve jetojnë në fshatrat jo të njohura zyrtarisht.) Që prej vitit 1948 Izraeli i ka përndjekur dhe zoluar ata me një gardh që zë 900 mijë dynym tokë, kështu buqësia e tyre është zvogëluar nga dy milion dynym në vetëm 240 mijë e shumta.”

►Fahmi Huwaidi, “*Tathir ‘Irqi Maskut ‘Alayh,*” (Pastrimi i Fshehtë Etnik), gazeta *al-Khaleej*, United Arab Emirates (UAE), 11/9/2007.



më të madh të mundshëm të popullsisë vendase jashtë vendit, të premtuar prej çifutëve, ka evoluar në të qënit një frymëzim sionist, nëpërmjet planeve dhe sugjerimeve të praktikuar qysh prej vitit 1937, e deri tani. P.sh. plani Dalet ose D, u bë realitet përmes politikës së vitit 1948.

Duke ndjekur etapat e themelimit dhe të planifikimit për të përndjekur arabët, shohim se plani filloi të zbatohet gjatë luftës së vitit 1948, i cili ishte i karakterizuar nga operacionet ushtarake të kryera prej sionistëve. Më të njohurit e këtyre planeve ishte plani Dalet, i cili përfshinte 13 operacione, secili prej tyre kishte kohë dhe vend të paracaktuar. Sipas burimeve çifute, plani Dalet ishte plani i parë strategjik i organizuar prej *Haganah*, për të pushtuar një sferë sa më të gjerë të zonës, si dhe për ta kontrolluar plotësisht atë. Qëllimi ishte spastrimi i fshatrave arabe, për t'i dëbuar arabët nga zonat e ndryshme, madje dhe nga vendet fqinje. Planu përfshin sundimin dhe shpronësimin e qyteteve të Safad, Tiberius, Haifa, Tel Aviv, Xhafa dhe të Jeruzalemit...⁷³

Gjithashtu, është vërtetuar nga një dokument i përgatitur prej inteligjencës së Ministrisë së Mbrojtjes çifute, “që operacionet ushtarake të bandave sionistë ishin shkaktarët kryesorë të dëbimit të 75% të popullsisë arabe nga Palestina. Dokumenti bën fjalë emigrimin arab nga Palestina, nga 1/12/1945 deri më 1/6/1948. Ky dokument u mor nga Benny Morris”.⁷⁴

Pas deklaramentit të pavarësisë apo themelimit të shtetit të Izraelit në vitin 1948, koncepti i transferimit sionist nuk po zbatohet plotësisht, ndërsa politika e dëbimit që praktikohet gjerësisht nga ushtria çifute, kishte dështuar kryekëput. Megjithatë, politika e shtetit çifut për t'u çliruar nga minoriteti arab, ka vazhduar njëloj. Me kalimin e viteve nuk ka pësuar asnjë ndryshim, por është bërë më e pranishme dhe vijon të ndiqet e tillë sot e kësaj dite. Përveç kësaj, dëbimi i 750 mijë palestinezëve arabë nga



shteti i porsakrijuar, u pasua gjerësisht dhe me uljen e popullsisë arabe nga mazhorancë, në minorancë. Udhëheqja pragmatiste e Partisë së Punës, mendoi se e kishte zgjidhur problemin e tokës së banimit, problemin

demografik, si dhe atë gjeopolitik, në një nivel të gjerë. Megjithatë, ajo dëshironte ta pranonte në heshtje ekzistencën e një bashkësie apo të një minoriteti arab, që arrin në 160 mijë vetë, nga 900 mijë palestinezë që banonin më parë në zonat që tani njihen si pjesë e “shtetit të Izraelit”. E gjitha kjo ka ndodhur gjatë luftës së 1948-ës.

Në përpjekjet e tyre për ta njohur ndërkombtarisht shtetin e porsakrijuar, këshilli i përkohshëm i shtetit të Izraelit, që parapriu parlamentin (Knesset-in) në “Dokumenti i Pavarësisë,” garantoj që shteti çifut “do të ushtronte të drejta të barabarta sociale e politike ndërmjet të gjithë qytetarëve të tij, pa dallim feje, race apo gjinie.” Megjithatë, ajo që ka ndodhur në vend, është krejtësisht e kundërta e deklaramit që kanë bërë në dokumentin e pavarësisë. Në të vërtetë, pas themelimit të shtetit të Izraelit, çifutët i konsideruan palestinezët si të huaj.

“Le të dihet ndërmjet nesh. Ne duhet të jemi të qartë që këtu nuk ka vend për dy popuj, pasi arabët të transferohen, vendi do të jetë krejtësisht i hapur për ne, nëse qëndrojnë në vend, vendi do të jetë i vogël dhe i kufizuar.... Zgjidhja e vetme është toka e Izraelit, ose të paktën tokat perëndimore të Izraelit (d.m.th. Palestina) pa arabë. Nuk ka rrugë për kompromisë rreth kësaj çështje.”

“Idea sioniste është përgjigja e çështjes çifute në tokën e Izraelit; (...) Evakuimi komplet i vendit nga banorët e tjerë të tij dhe dorëzimi i saj tek populli çifut është zgjidhja e vetme.”

➤ Shkëputur nga ditari i shkruar me dorë (më 20.12.1940 dhe 20.3.1941) nga Yosef Weitz (1890-1972), Department of the Jewish National Fund shiko:

Weitz Diary, A246/7, fq.1090-1091 & 1127 Central Zionist Archives (CA), citohet në Nur Masalha, *The Expulsion of the Palestinians*, (USA: Institute for Palestinian Studies, 1993), fq. 131-132.



Gjithashtu, autoritetet janë përpjekur vazhdimisht, duke përdorur metoda të ndryshme, për t'i dëbuar palestinezët që kanë mbetur në shtëpitë e tyre. Kohë pas kohe, ata e kanë kryer këtë procedurë, nëpërmjet grupeve vullnetare, nga projekti i transferimit me forcë, si dhe nëpërmjet dëbimit të palestinezëve me dhunë. Imponimi i sundimit ushtarak te popullata arabe, e ka ndihmuar Izraelin për të arritur përfundimet e tij të mbrapshta. Gjithashtu, planet ushtarake, strategjike, demografike, së bashku me politikën e vendbanimeve apo dhe ideologjitë sioniste pas 1948-ës, kanë kontrolluar aktivitetet e transferimit si dhe disa operacione të dëbimeve gjatë vitit 1950. Fakte këto që na shtyjnë për të kërkuar shpjegim për dëbimet masive e të vazhdueshme të palestinezëve nga toka e tyre, pavarësisht faktit të themelimit të shtetit të tyre, dhe dëbimit prej mazhorancës. Përgjigja e kësaj pyetje shtrihet thelbësisht në përhapjen e ndjenjës tek udhëheqësit sionistët, që aty ka ende “shumë arabë”, një ndjenjë që buron prej parimeve themelore dhe premisë së sionizmit. Veçanërisht, parimi për të patur një shtet çifut që të jetë demografikisht homogjen, “që shumica e tokës të jetë e kontrolluar nga çifutët dhe të ketë shumë pak arabë në të”.

Këtë lloj ndjenje mund ta kuptojmë nga shumë deklaramë të bëra nga çifutë të ndryshëm, si kryetari i stafit të IDF(1949-1952) Igal Yadin, i cili i pat deklaruar nën zë kryetarit të qeverisë, se “minoriteti arab përbën një rrezik për shtetin gjatë ditëve të paqes, ashtu si edhe gjatë ditëve të luftës”.⁷⁵ Më poshtë janë përmendur disa qendrimë të mbajtura nga zyrtarë të lartë qeveritarë:

Deputi Shlomo Lavi : “Ka shumë arabë në vendin tonë”.

- **Ish-presidenti i Izraelit Yitzhak Ben-Zvi, (1952-1963):**
- **“Jam shumë i shqetësuar nga ky numër i madh arabësh. Mund të ndodhë që të na çojë në një pozitë që mund të jemi minoritet në**



shtetin e Izraelit. Numëri i arabëve sot në vend është 170 mijë, prej nga, 22 mijë meshkuj janë në moshën e arsimit të detyruar”.

- Yehiel Duvdevani, deputet i parlamentit:
- “Nëse ka një rrugë për të zgjidhur problemin e transferimit të 170 mijë arabëve të mbetur në Izrael, atëherë ne do ta bëjmë atë”.⁷⁶
- Shamuël Dayan, babai i Moshe Dayan, deputet dhe kryetar i Partisë së Punës, në një takim të organizuar nga partia e tij në vitin 1951, deklaroi: “Izraeli nuk mund ta lejojë kolonën e pestë arabe që të forcohet në shtet. Në të njëjtin takim, Ministrja e Punës, Golda Meir, në qeverinë e Ben Gurionit, deklaroi: “do të ndihesha e neveritur, kur të dëgjoja një arab që t’i betohej besnikërisht tre here në ditë shtetit të Izraelit”.⁷⁷
- Ministri i Jashtëm Moshe Sharett (Shertok), më vonë edhe kryetar i qeverisë deklaroi: “Do të ishte mirë sikur mos të kishim arabë në vendin tonë.”⁷⁸, Ben-Gurion, deklaronte:

“Këta arabë nuk duhet të banojnë këtu, ashtu si dhe çifutët e Amerikës nuk duhet të banojnë në Amerikë...Jam i mendimit se ne duhet të bëjmë çmos që arabët të vendosen në një shtet arab, sepse arabët kanë shtete ... dhe n.q.s. plas ndonjë luftë, të gjithë arabët (banues në Izrael) do t’ia mbathin nga frika se mos i therrim ne, ose do të mendojnë se do t’u vijnë në ndihmë shtetet e tjera arabe, për të na shfarosur”.⁷⁹
- Në vitin 1950, Moshe Dayan, komandant i komandës jugore, ndërsa po shprehte opinionet e tij ekstremiste ndaj palestinezëve të Izraelit, që i konsideronte si kolonë ë e pestë, deklaroi : “Shpresoj se në të ardhme, do të kemi shanse të tjera për të transferuar arabët nga toka çifute, dhe nëse kjo mundësi vjen, ne nuk duhet ta humbasim për asnjë arsye në botë këtë shans”.⁸⁰



Secili nga ne, kur i lexon këto deklarime të bëra nga themeluesit, militantët dhe udhëheqësit politikanë të sionizmit, nuk e ka të vështirë të konstatojë ‘etosin’ apo shpirtin që kontrollon veprimin e tyre ndaj popullsisë arabe. Është e rëndësishme të përmendim këtu, që këto thënie nuk janë thjesht retorikë boshe, por janë zbatuar pikëpërpikë, përmes përndjekjeve të planifikuara dhe sistematike ndaj palestinezëve, për dekada me radhë. Përndjekja e arabëve është bërë në çdo kohë, përmes eksplorimit të realiteteve të krijuara nga udhëheqja e imponuar militare, apo përmes rezultateve të disa rrethanave të sigurta që ishin dominuese në rajon. P.sh., gjatë viteve të para të themelimit të shtetit, më shumë se 10 mijë arabë palestinezë, u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga ushtria çifute. Gjithashtu, u dëbuan edhe disa mijëra refugjatë palestinezë, të cilët në mënyrë klandestine, arritën të ktheheshin rishtazi në fshatrat dhe qytetet e tyre.

2.700 palestinezë të mbetur në qytetin Maxhadal(në jug), në verë të vitit 1950, morën urdhërin e transferimit. Kështu, ata i transferuan për një kohë të shkurtër afër kufinjve me Rripin e Gazës.⁸¹ Gjithashtu, në nëntor të vitit 1949, rreth 500 familje beduinësh ishin të detyruar të shpërnguleshin nga zona e Beersheba dhe të kalonin kufirin për në Bregun Perëndimor. Jordania protestoi kundër këtij dëbimi. Një tjetër operacion dëbimi ishte ai i fisit azazmeh, apo edhe ai i fisit al-xhahalin, në maj të vitit 1950, ku 700-1000 prej tyre u dëbuan me forcë në Jordani. Gjithashtu, më 2.9.1950, ushtria çifute arrestoi qindra burra nga fisi i azazmeh nga Negev, dhe i transferoi me dhunë në Egjipt.

Morris, ka përmendur në një fjalim të mbajtur nga ministri i jashtëm çifut, që gjatë periudhës mes viteve 1949-1953, çifutët kanë shpërngulur e shpronësuar rreth 17 mijë beduinë të Negevit. Në vitin 1951, numëri i arabëve në Negev u zvogëluar nga dëbimet, shpronësimet dhe largimet.



Pra, numëri i palestinezëve, nga 65 mijë shkoi në 13 mijë.⁸² Në vitin 1953, në raportet e mbajtura prej K.B., përmendet se 7 mijë beduinë arabë, thuajse gjysma e të cilëve i përkasin fisit azazmeh, u dëbuan me dhunë nga Negevi.⁸³

Operacioni i dëbimit në masë ndodhi edhe në zonën e Trekëndëshit (*al-Muthallath*), pas përfshirjes së saj në shtetin e Izraelit, në maj të vitit 1949, duke vijuar me firmosjen e marrëveshjes së Rhodesit me Jordaninë më 3.2.1949. Ndërsa në fund të majit të vitit 1949, ushtria dëboi 4 mijë “refugjatë të brendshëm”⁸⁴ nga zona e vogël trekëndëshe, përtej kufirit të B.P.⁸⁵

Po gjatë atij viti, Izraeli ka dëbuar rreth një mijë persona nga fshati i Bakah al-Gharbijah i zonës së Trekëndëshit, përtej kufirit të Bregut Perëndimor. Në shkurt të vitit 1951, çifutët kanë dëbuar e shpronësuar popullsinë indigjene të 13 fshatrave të vogla arabe nga Wadi’ Arah (në krahinën e Haifa), deri jashtë kufinjve. Gjithashtu, më 17.11.1951, forcat çifute dëbuan popullatën e fshatit të Khirbat Buایشan, i cili ndodhet po në Trekëndëshin e Vogël, duke ia hedhur në erë shtëpitë. Në prill të vitit 1949, konsullata e SHBA-ve në Jeruzalem, përmendi në fjalimin e saj se “disa qindra” arabë të Galilee (të cilët janë të gjithë shtetas izraelitë) u dëbuan nga ushtria çifute përtej kufinjve.⁸⁶

Më 30.10.1956, një ditë pas masakrës së Kafr Kasimit, gjenerali Yitzhak Rabin, i cili atëherë ishte komandanti i komandës së veriut, e më vonë u zgjodh dy herë si kryeministër - duke përfutur nga avantazhi që kishte - sulmoi jugun e Egjiptit (agresioni tripjesësh), dhe ndërmori operacionin e dëbimit të popullatës arabe në mënyrë masive, duke i shpënë në kufirin e veriut me Sirinë. Ai dëboi nga dymijë deri pesëmijë persona nga fshatrat e Krad al-Ghannamah dhe Krad al-Bakarah, që



ndodhen në jug të liqenit Hula. Këto popullata u përzunë edhe në vitin 1951, nga fshatrat e tyre të origjinës, gjatë projektit të transferimit ujon. Rreth këtij incidenti kriminal, Rabini mburrej në ditarin e tij, duke shkruar kështu: “E zgjidha problemin në veri, duke përfitur nga avantazhi i luftës me egjiptianët dhe nga bashkëpunimi me K.B. Ne kemi transferuar dymijë arabë, të cilët përbëjnë një barrë të rëndë të sigurisë për Sirinë”. Po në të njëjtin incident të ndodhur në vitin 1956, ushtria izraelite dëboi nga dymijë deri në pesëmijë fshatarë arabë nga rezidenza e Galilee për në Siri. Dhe kur bashkëbiseduesi e kishte pyetur për ndonjë reagim të mundshëm nga ana e fshatarëve të dëbuar me forcë, ai iu përgjigj: “Unë nuk kam marrë ndonjë vendim demokratik, sa i përket kësaj çështjeje”.⁸⁷

Nëse ideja e transferimit të palestinezëve në Izrael ka qenë pjesë thelbësore e projektit sionist, dhe nëse në të kaluarën ka qenë dikush që është përpjekur ta bëjë këtë koncept më pak të ashpër dhe paksa të këndshëm, zhvillimet e dëshmuara nga kjo ide, në radhë të parë, e kanë kthyer atë në një parti politike, dhe më pas në “trashëgimi sioniste”. Kjo duhet të jetë sugjeruar si pjesë e kurrikulës edukative, jo vetëm për çifutët, por edhe për studentët arabë. Nisur nga kjo pikëpamje, Ministri i Edukimit, Limor Livnat, bën thirrje për indoktrinimin e “trashëgimisë” së Rehavam Ze’evit në shkollat çifute. Vlen të përmendim këtu themeluesin e Partisë Moledet në vitin 1988, si dhe mbrojtësin e flaktë të ideologjisë së transferimit, Ze’ev, i cili deklaroi se nëse transferimi ishte jo-etnik, atëherë sionizmi ishte gjithashtu jo-etnik. Gjithashtu ai deklaroi se punëtorët palestinezë ishin si morrat që duhen qëruar, dhe se ata janë përhapur si kancer.⁸⁸



Serioziteti i deklarimit të Ze'evit, qëndron në faktin se ai është shprehur ashtu si mendonin udhëheqësit e Likudit. Ata gjithmonë kanë menduar se “toka e Izraelit është një tokë për një popullatë të vetme homogjene, dhe ata janë çifutët”.⁸⁹

Në këtë çështje, vlen të përmendim që vrasja e Ze'evit është kryer në Jeruzalem më 17.10.2001 nga rezistenca palestineze. Megjithatë parimet dhe idetë e tij kanë ngelur si një burim frymëzimi për ambjentin çifut. Ata kanë shkuar aq larg, sa kanë adaptuar qendrimet me disa nga politikanët dhe akademikët çifutë të drejtimeve të ndryshme politike, ashtu si dhe me ata të bashkimit ideologjik.⁹⁰

Duket se qeveria çifute nuk ka gjetur dot mjaftueshmërinë e zbatimit të politikës së dëbimit në masë të popullatës arabe të mbetur në Izrael. Prandaj, ata kanë skicuar, së bashku me operacionin e dëbimit, një paketë skemash e projektesh për të transferuar arabët në vendet e tjera të botës. Izraeli e bën këtë gjë me justifikimin që kjo bazohet në akte preçedente, duke cituar shembuj të transferimit që kanë ndodhur në shek. e 20-të, si p.sh. transferimi i turqve, indianëve, pakistanezëve, gjermanëve dhe vende të tjera evropiane. Kështu, Izraeli mendon se duke i çrrënjosur palestinezët, e duke i zhvendosur ata në vendet e tjera arabe, nuk bën gjë tjetër veçse një lloj risistemimi.

Me këtë lloj prapaskene dhe ndjekje të politikës që synon transferimin e arabëve, Izraeli ka përpunuar nëpërmjet institucioneve të ndryshme, mundësi të reja për të siguruar rrethana të përshtatshme për të arritur qëllimin e tij. Kështu, ka orkestruar një numër skemash dhe projektesh për transferimin e popullatës arabe. Disa nga këto skema përpiqen që të inkurajojnë arabët, që të lënë tokën e shtëpitë e tyre, duke iu ofruar atyre si karem, stimulimin ekonomik dhe financiar. Kjo, si rrjedhojë e proçedurave të zakonshme të frenimit. Disa prej këtyre skemave janë



ato të operacionit Johanan dhe atij të Libisë, të cilat dështuan që të dyja bashkë. Përveç kësaj, dëshira e çifutëve për të arritur qëllimin e tyre të mbrapshtë, i ka çuar të kryenin një mori skemash të tjera, me bazë dhunën dhe masakrat e planifikuara, si p.sh Operacioni Hafarferet.

Një nga planet e fundit më të rëndësishme, apo projekti që është ende në punim e sipër, dhe që duhet diriguar për të transferuar arabët, është plani Negev 2015 (plan zhvillimi), i cili njihet si “Plani i Zhvillimit të Strategjisë Nacionale Negev” (në vitin 2005). Synimi kryesor i këtij plani është rritja e numrit të popullsisë çifute të Negevit në 900 mijë vetë, brenda periudhës 10 vjeçare. Për ta vënë në zbatim këtë plan, është vënë në dispozicion një shumë prej 3.9 bilion dollarësh.

Plani nuk e njih ekzistencën e qyteteve arabe në Negev, si dhe i konsideron ato si pengesë për zbatim,⁹¹ çka praktikisht do të thotë dëbim dhe çrrënjosje prej këtyrë qyteteve të panjohura, zbatimi i të cilit tashmë ka nisur në Negev.

Më 28.4.2007, gazeta “*Yedioth Ahronoth*”, ka zbuluar një plan të ri që po merret në konsideratë nga qeveria çifute. Ky plan është propozuar nga deputeti i Kadima-s, Otniel Schneller, ku përfshihet përsëri një shenjim, apo një gjurmë e ‘Linjës Jeshile’ (Green Line), në mënyrë që të “shkaktojë një ndryshim demografik të mprehtë”. Sipas gazetës në fjalë, ekziston një ngjashmëri midis planit Schneller dhe atij të Avigdor Liberman, i cili ka bërë thirrje për ndarjen e zonës së Trekëndëshit nga Izraeli, duke ia kaluar atë autoritetit palestinez. Në fakt, Schneller e ka theksuar këtë gjë, por, ai ka theksuar më tej se diferenca midis dy planeve është kohëzgjatja e zbatimit të tij. Plani i tij duhej të zbatohet brenda 30 vjetëve, ndërsa plani i Libermanit duhet të zbatohet menjëherë.



Sipas Schneller, arabët që përfshihen në të, nuk kanë mundësi për t'u vendosur në zona të tjera të vendit. Gjithashtu, atyre nuk u lejohet të merren me biznese, si dhe të shprehin interesa ekonomike në Izrael. Megjithatë, ata mund të punojnë në qytetet çifute. Por me një kusht, që të përpiqen të sigurojnë leje të posaçme për këtë. Schneller shpjegon më tej se gjatë periudhës së planit 20-30 vjeçar, në rast se përfundojmë një marrëveshje me palestinezët - që përfshin krijimin e një shteti palestinez dhe përfshirjen e vendbanimeve në Izrael - popullsia e zonës së 'Trekëndëshit' do të përfitojë shtetësinë, me një kusht të veçantë: do të jenë shtetas çifutë dhe në të njëjtën kohë, pjesë e shtetit palestinez.⁹²



Nakabaja 1948 (Katastrofa)

Viti 1948 është më i përgjakshmi e më i dhunshmi. Në këtë vit gangsterët sionistë përdorën të gjitha mjetet e terrorizmit, vrasjet dhe masakrat për dëbimin e palestinezëve nga trojet e tyre. Me qindra mijëra palestinezë u dëbuan nga trojet e tyre, pa më të voglën përgatitje dhe paralajmërim. Ata u larguan për të shpëtuar kokat e tyre.



Kapitulli 5: Dhuna e shenjtoreve

“Shpërthimi u krye nga rojet e bregut dhe sipas urdhërave të mia”. Kjo ishte përgjigjia e komandantit të komandës jugore të ushtrisë çifute Moshe Dajan, kur e pyetën për operacionin e shpërthimit të faltores së *Imam Husain* në Maxhdal, në korrik të vitit 1950.

Sipas profesorit Ejal Benvenisti, më pak se 40 nga 160 xhami që ekzistojnë në fshatrat palestineze, janë nën “Marrëveshjen e Amnistisë”, dhe që mbeten nën kontrollin e Izraelit, si të paprekshme deri në kohët e sotme.⁹³

Liria e besimit është konsideruar si një nga mjetet më të rëndësishme të të drejtave të qytetarit. Është një nga shtyllat e të drejtave kulturore, dhe një nga pjesët më kryesore apo komponentet bazë për zbatimin e tyre. Kjo, për arsye të lidhjes së fortë apo të ndërlidhjes së këtyre lirive



dhe të drejtave të traditës, kulturës, individit dhe identitetit kolektiv të shtetasve të çdo shteti.

Pavarësisht nga të gjitha këto raporte të bëra nga një numër organizatash dhe institucionesh islamike të të drejtave të njeriut, në Izrael konstatohet se qeveritë pasardhëse çifute, nuk kanë bërë asgjë në angazhimin e tyre, për të mbrojtur të drejtat kulturore dhe fetare të minoritetit arab në Izrael. Përkundrazi, raportet kanë konstatuar se ekziston një strukturë e mirëorganizuar për shkeljen e këtyre të drejtave, duke i ndaluar qytetarët muslimanë e të krishterë arabë, për të frekuentuar një numër vendesh të shenjta, siç janë xhamitë dhe kishat. Kjo ndodh për shkak të mbylljes së tyre, për të cilat jepen pretekste të ndryshme. Gjithashtu, përmes shkatërrimeve direkte dhe përdhosjes së shenjtorëve dhe vendeve të shenjta, apo edhe shfrytëzimit të disa xhamive dhe kishave në fshatrat e shpopulluara, duke i kthyer ato në stalla bagëtish, magazina apo ambjente bar-kafeneshë. Gjithashtu, qeveria çifute nuk është përpjekur aspak të marrë masat e duhura për të ndaluar disa grupe çifute, që i shndërronin xhamitë në faltore vetëm për çifutët.⁹⁴

Që prej themelimit të shtetit çifut, të gjitha pronat e Waqf, ndihmat islamike, janë konfiskuar dhe i janë kaluar shtetit. Sa për pronat e besimtarëve kristianë, ato kanë mbetur nën mbikqyrjen e autoriteteve respektive. Manastiret kanë vazhduar punën e tyre, ashtu si para vitit 1948. Kjo, për shkak të ndjeshmërisë së lartë dhe autoritetit të vendeve perëndimore të krishtera, sidomos të Vatikanit. Pavarësisht nga kjo, pjesë të trojeve që janë nën autoritetin e kishës së krishterë, përfshirë këtu edhe ato në fshatrat e rënuara, kanë qenë të pambrojtura ndaj operacioneve konfiskuese, të kryera nga institucionet shtetërore.⁹⁵



Vlen të përmendim këtu, se për të kontrolluar burimet, sistemin e ndihmave islamike dhe atë të tokës, që arrin në 6.2% të territorit në Izrael, autoritetet kanë nxjerrë një sërë ligjesh ndër më të rreptat, si p.sh. ligji i mungesës së pronarit të tokës, apo dhe llogaritjen e tokës së vendosur për kontribut, që është konfiskuar nga ligje të tilla, ka arritur në 80%, apo 244,430 dynym.⁹⁷

Padrejtësia kronike që ushtrohet ndaj palestinezëve muslimanë që jetojnë në Izrael, nuk ka qenë vetëm plaçkitja e tokave apo kontributeve të tyre, por çifutët kanë tejkaluar çdo lloj kufiri njerëzor, duke përdhosur e dhunuar sistematikisht vendet e shenjta dhe ato të adhurimit. Kjo është kryer në mënyrë skandaloze dhe pa cak njerëzor, në një nivel të atillë, sa e ka shtyrë sheikun Raid Salah, të akuzojë publikisht shtetin, si diskriminues fetar ndaj muslimanëve.

Është provë evidente që çifutët kanë prishur më shumë se një mijë xhami, gjatë dhe pas vitit 1948, si dhe kanë konfiskuar të gjitha kontributet islamike. Ata kanë vazhduar ushtrimin e dhunës sistematike, ku më shumë se 70 xhami i kanë kthyer në restorante, klube dhe muzeume. Gjithashtu, kanë vijuar të hapin varret e muslimanëve, duke zhvarrosur trupat dhe eshtrat e tyre, duke ndërtuar në to rrugë, hotele dhe lagje banimi. Gjithashtu, çifutët vazhdojnë të ndalojnë muslimanët që të kryejnë faljen e tyre në shumë xhami, siç janë xhamia e al Gabisijah Hittin, Kisarjah, etj.

Ata kanë ndaluar thirrjen e ezanit në dhjetë xhami. Kanë ndaluar muslimanët që t'i varrosin të vdekurit në varrezat muslimane. Kjo është vazhdimësia dhunuese e linjës zyrtare çifute, për të damkosur zekatin dhe fondet ndihmëse, duke i etiketuar këto fonde bamirësie si “mbështetëse të terrorizmit dhe përkrahësve të tij”.⁹⁸



Përfundimisht, presidenti i Gjykatës së Sheriatit, Ahmed Natur, i ka nisur një letër presidentit të qeverisë,⁹⁹ në të cilën flitet për gjendjen e mjerueshme të vendeve të shenjta islamike, veçanërisht në qytetet e përziera, si dhe në zonat ku nuk ka muslimanë. Veç kësaj, ai përmend ligjin e tokës që i mungon pronari, ligj i cili përfshin disa pika që kanë dëmtuar rëndë pronat dhe financiat, dhe që bien ndesh me sheriatin islamik. Gjithashtu, ai kritikoi ashpër këtë ligj, pasi ai lejon të shfrytëzohen fondet e Waqf-it për qëllime që bien ndesh me ato që përshkruhen në të. Ahmed Natur tërheq vëmendjen se Waqf, nga pikëpamja e sheriatit dhe asaj legislative, nuk është thjesht për të shërbyer. Prandaj, ai i paralajmëroi për pasojat e rënda të këtij praktikimi të pabazë nga “Komitetet e Besueshmërisë”, të caktuara nga autoritetet vendore. Shumë prej atyre që janë në krye të këtyre komiteteve, ose nuk janë personalitete të përshtatshëm, ose janë bashkëpunëtorë të të tjerëve.

Madje, në disa raste, disa prej tyre kanë shitur edhe xhamitë. Gjithashtu, ai deklaroi në letrën e tij, se përdorimi i disa komisioneve qeveritare dhe bashkiake, dhunon në mënyrë poshtuese vendet e shenjta, siç janë xhamitë, si dhe njolloso paprekshmërinë e tyre. Gjykatësi përmendi gjithashtu se administratorët apo kujdestarët, duhet të kujdesen për t’i mirëmbajtur vendet e shenjta islamike. Ata duhet të jenë besnikë ndaj legjislacionit, dhe po sipas ligjit, janë të detyruar ta zbatojnë rigorozisht. Kjo vjen si pasojë e refuzimit të autoriteteve për të lejuar muslimanët të riparojnë vendet e tyre të shenjta.

Përveç kësaj, ai diskutoi edhe për aktet e dhunimit, shkatërrimit dhe rrënimit të xhamive dhe të varrezave, si dhe shpronësimin e disa prej tyre, duke i kthyer ato në vende adhurimi për çifutët, apo edhe më keq, në shtëpi qejfi, si strehë për amoralitetin dhe për moralprishurit. Prandaj, ai i bëri thirrje autoriteteve që të zbatojnë ligjet, që mbrojnë



paprekshmërinë e vendeve të shenjta, si dhe të dënojnë ata individë apo autoritete që, dhunojnë vendet e shenjta. Ai gjithashtu bëri thirrje për revokimin e Komiteteve të Besueshmërisë, ndryshimin e ligjit të mungesës së pronarit, si dhe ndërprerjen e ndërtimeve në varreza.

Shkatërrimi i vendeve të shenjta të muslimanëve dhe të kristianëve, që ka nisur që prej luftës së vitit 1948, kohët e fundit është dyfishuar. Vazhdimësinë e dhunimit të ligjit ndërkombëtar nga çifutët, e konstatojmë në ilustrimet e mëposhtëme :

- **Shkatërrimi i xhamive, kur besimtarët u përpoqën që t’i riparonin, si p.sh. në fshatrat e Sarafand, Umm al-Faraxh dhe Uadi al-Hauarith.**
- **Shkatërrimi i xhamive të ndërtuara nga shtetasit arabë, të cilët nuk kanë xhami tjetër aty afër. Shembull tipik është fshati i Tal al Mihil.**
- **Kërcënimet në mënyrë konstante të policëve, zyrtarëve të shtetit dhe popullsisë çifute lokale për besimtarët, të cilët përpiqeshin të shkonin në vendet e tyre të shenjta, si p.sh. në fshatrat e al-Ghabisija, Hittin dhe Sihmata.**
- **Mbyllja e vendeve të shenjta, të konsideruarat “zona të ndaluara”, për t’i ndaluar arabët për të shkuar në to. Përmendim këtu fshatrat e al-Basah, al-Manshijah, si dhe xhaminë e madhe të Bershebës.**
- **Heqja dorë nga zbatimi i rregullave që ndalojnë faltoret për të qenë të shenjta, në mënyrë që t’u lejohet pronarëve të rinj çifutë, për të asgjësuar shenjtërimin dhe paprekshmërinë e tyre, duke i kthyer ato në klube, kafene apo shtëpi banimi, siç ka ndodhur me xhamitë e Ain haud, Ashkelon dhe Kisarijah.**



▪Miratimi dhe marrëveshja zyrtare, bazuar në pretendimet e besimtarëve çifutë, se vendet e shenjta muslimane janë vende adhurimi për besimtarët çifutë, si p.sh. nga Profetin Robin, Lifta, Uadi Hanin dhe al-Jazur. Shkatërrimi i varrezave të muslimanëve dhe kristjanëve, në mënyrë që autoritetet të shtrojnë rrugë, si dhe të ndërtojnë në to vendbanime apo komplekse industriale, siç ka ndodhur në fshatrat e al-Basah, Dir Jasin, dhe Sarafand al-Amar.

Ky dhumim i vendeve të adhurimit të muslimanëve dhe kristjanëve, u përkeqësua më shumë, kur procedura e ndjekur mori trajta flagrante të diskriminimit. Siç janë mungesa legale për njohjen e vendeve të adhurimit për kristjanët dhe muslimanët, mungesa e caktimit të buxhetit për xhamitë dhe kishat, mungesa e zhvillimit të turizmit në zonat arabe, si dhe mungesa flagrante e mbrojtjes së faltoreve.

Kjo, si rrjedhojë e procesit të gërmimeve nën faltoret e zonave arabe, si dhe vazhdimësia në përndjekje të udhëheqësve fetarë, të cilët shprehin pakënaqësitë dhe kundërshtimet e tyre ndaj policëve çifutë.

Nga këto strategji të sipërmendura dhe të panumërta, duket qartë se ajo që dëshirojnë çifutët, është zhdukja nga faqja e dheut, si dhe lënia në harresë e kulturës dhe traditave shumëshekullore të muslimanëve dhe të krishterëve palestinezë.¹⁰⁰



Janë kryer dy shkelje të të drejtave, një kundër lirisë dhe tjetra kundër shamisë një nga simbolet e fesë Islame. Në këtë foto, një vajzë e re dhe një djalë po sulmojnë një grua palestineze përpara ushtarëve izraelitë.



Mbyllje

Pavarësisht nga të gjitha këto që përmendëm në këtë studim të përmbledhur, rreth racizmit çifut dhe diskriminimit të tyre kronik ndaj shtetasve arabë, ajo që mbetet faktike, është shumë më shumë se çfarë ju bëmë me dije në këtë përmbledhje kronologjike. Dosja e racizmit në Izrael është aq e madhe dhe aq e ndërlikuar, sa është e vështirë për t'u përmbledhur e tëra, edhe në një studim voluminoz. Megjithatë, ajo çfarë është dokumentuar në këtë studim, mendojmë se mbetet e mjaftueshme për ta treguar qartë Izraelin, si një shtet racist. Shembujt përgjatë gjithë librit, konstatojnë paragjykimet dhe diskriminimet që u bëhen palestinezëve nga shteti i Izraelit, si dhe vërtetojnë, përtej hijes së dyshimit, ekzistencën e dy shtresave shoqërore thelbësisht të ndryshme, që janë diskriminuar sistematikisht nga ana fetare dhe kombëtare.



Nga njëra anë, kjo ndodh si shkak i kundërshtimeve themelore dhe ato të trashëguara, që ekzistojnë në karakteristikat e Izraelit si një “shtet çifut”, apo edhe konstruktit të tij institucional, duke i bërë privilegje vetëm popullsisë çifute, që dikton emrin, flamurin, himnin kombëtar, festat publike dhe simbolet - që duhet të jenë vetëm çifute - ndërsa nga ana tjetër, adoptimit të politikave “demokratike” ndaj kategorisë tjetër të qytetarëve, të cilët nuk bëjnë pjesë në këtë përshkrim kombëtar dhe fetar të shtetit. Si përfundim, a është e vështirë ta shquash këtë diskriminim të shfrenuar në çdo skaj? Në deklaratimet e simboleve, udhëheqësve, librave dhe kurrikulave të arsimimit, të diktuar apo të imponuara nga ligjet! Madje dhe ajo që nuk diktohet nga ligji, vihet në zbatim të përditshëm në bisedat, gazetatat, në vendet e punës, në sjellje dhe vendime gjyqësore të panumërta. Çka nënkupton se diskriminimi është tejet evident, edhe kur të detyrojnë t’i thuash “derrit dajë”, racizëm ky i përhapur në përmasa të tilla, që e bën të vështirë për të besuar se këto shembuj e ngjarje, janë koinçidenca thjesht rastësore, apo praktika të jashtëzakonshme. Ky është thjesht racizëm!



Endnotes

- ¹ Khalid Mahmud al-Kawmi, “*Hawla al-Tashabuh wa al-Tatabuq bayna al-‘Unsurayah wa al-Suhyunyah fi al-Nazariyah wa al-Tatbiq wa Mawqif al-Mujtama‘ al-Duwali minhuma,*” (Ngjashmëritë dhe bindjet midis racizmit dhe sionizmit në teori dhe praktikë dhe pozicioni i bashkimit ndërkombëtar), revista *al-Katib al-Filastin i*, Damask, Nr. 20, 1990, fq. 80-86.
- ² Fayiz Rashid, *Zayf Dimuqratiyat Israel (Falsiteti i Demokracisë së Izraelit)* (Beirut: Instituti Arab për Studime dhe Botime, 2004), fq. 71-73.
- ³ Tariq Ibrahim, ‘*Ala al-Hamish: Al-Taqrir al-Sanawi li Intihakat Huquq al-Aqalliyah al-‘Arabiyah al-Filastiniyah fi Israel li al-‘Am 2006* (Kufi: Raporti vjetor për shkeljen e të drejtave të minoritetit arab palestinez në Izrael për vitin 2006), Instituti arab për të drejtat e njeriut, qershor 2007.
- ⁴ Tariq Ibrahim, *al-Qatil Wahid wa al-Mas’ulun Kuthur* (Vrasësi është një dhe përgjegjës janë shumë), Instituti Arab për të Drejtat e Njeriut, Nazareth, 2005, fq. 13.
- ⁵ Ibid., fq. 14.
- ⁶ Ibid., fq. 16.
- ⁷ Gazeta *Haaretz*, 22/3/2002.
- ⁸ Amnon Barzilai, *Haaretz*, 25/2/2004.
- ⁹ Gazeta *Yedioth Ahronoth*, 15/10/2004.
- ¹⁰ *Gazeta As-Sennara*, Nazareth, 13/2/2004; dhe *Gazeta al-Mithaq*, Yemen, 13/2/2004.
- ¹¹ Meron Rapoport, *Haaretz*, 29/4/2005.
- ¹² Paul Eidelberg dhe Will Morrissey, “Islami dhe Nazizmi,” revista *Nativ*, Qendra Ariel për Studime Politike (ACPR), Vol. 16, nr 92/3, Maj 2003.
- ¹³ Gazeta Samir al-Heija, *Sawt al-Haq wa al-Hurriyah*, Palestine, 21/3/2003.
- ¹⁴ *Gazeta Ma‘ariv*, 2/11/2003.
- ¹⁵ Amnon Rubinstein, *Ma‘ariv*, 13/10/1975.
- ¹⁶ Nimr Sultani, *Muwatinun bila Muwatanah: Taqrir Mada al-Sanawi al-Awwal li al-Rasd al-Siyasi-Israel wa al-Aqalliyah al-Filastiniyah 2000-2003* (Qytetarë pa shtetësi: Raporti i Parë Vjetor Mada për Vrojtimin Politik: Izraeli dhe Minoriteti Palestinez 2000-2003), përkthyer nga Jalal Hasan, Jamal ‘Ashur and Marzuq Halabi (Haifa: The Arab Center for Applied Social Research, 2003), fq. 161; dhe *Haaretz*, 9/8/2002.



- ¹⁷ Për më shumë informacione, shiko: Nimr Sultani, *Muwatinun bila Muwatanah* (Qytetarë pa shtetësi), fq. 47-93 dhe 159-163.
- ¹⁸ Për më shumë informacione, shiko: *Ibid.*, fq. 129-147.
- ¹⁹ Për më shumë informacione, shiko: *Ibid.*, fq. 125-147; dhe Nimr Sultani, *Israel wa al-Aqalliyah al-Filastiniyah 2003* (Izraeli dhe minoriteti palestinez, 2003) (Haifa: Mada al-Carmel-The Arab Center for Applied Social Research, 2004).
- ²⁰ Center for the Campaign Against Racism, *Mulakhhkas Miqyas al-'Unsuriyah 2006* (Përmbledhje e indeksit të racizmit 2006), 26/3/2007, shiko:
<http://www.no-racism.org/arabic/default.asp?flag=ShowPubDetails&pubid=58>
- ²¹ Shiko: Amin Faris, *Mizaniyat al-Dawlah wa al-Muwatinun al-'Arab: Taqirir Ijtima 'i-Iqtisadi li al-'Am 2004* (Buxheti i shtetit dhe qytetarët arabë: Raporti social-ekonomik 2004), përkthyer nga Ru'a Centre for Translation and Publication (Haifa: Mossawa Center-The Advocacy Center for Arab Palestinian Citizens of Israel). (in Hebrew)
- ²² *Al-Faqr Yastathni al-Muwatinin al-'Arab al-Akthar Faqran* (Varfëria përjashton qytetarët arabë të cilët janë më të varfërit), site of al-Mashhad al-Israeli, 10/2/2006.
- ²³ *Ibid.*
- ²⁴ *Ibid.*
- ²⁵ Amin Faris, *op. cit.*
- ²⁶ Për më shumë informacione shiko: Nimr Sultani, *Muwatinun bila Muwatanah* (Qytetarë pa shtetësi), fq. 101-123; Tariq Ibrahim, *al-Qatil Wahid wa al-Mas'ulun Kuthur* (Vrasësi është një dhe përgjegjësit janë shumë), fq. 15; gjithashtu shiko sondazhet mujore të kryera nga Tel Aviv University, dhe publikuar në *Haaretz*; dhe Indeksi Demokratik në Izrael të kryera çdo vit nga The Israel Democracy Institute.
- ²⁷ Tariq Ibrahim, *'Ala al-Hamish* (Në Kufi).
- ²⁸ Për më shumë informacione për Murin Ndarës, historinë, dimensionin dhe ndërlirimet e tij, shiko, see: Tariq Ibrahim, *Min Wara' al-Aswar* (Përtej Mureve) (Nazareth: Arab Institute for Human Rights, 2005). (in Hebrew)
- ²⁹ Center for the Campaign Against Racism, *Mulakhhkas Miqyas al-'Unsuriyah 2006* (Përmbledhje e Indekseve të Racizmit 2006).



- ³⁰ Gazeta *Haaretz*, 12/3/2007; and *al-Bayan*, United Arab Emirates (UAE), 14/3/2007.
- ³¹ Abdel Wahab el-Messiri, *Mawsu'at al-Yahud wa al-Yahudiyah wa al-Suhyuniyah: Namudhaj Tafisiri Jadid* (Enciklopedia e çifutëve, judaizmit dhe sionizmit: Modeli i ri i shpjguesit) (Cairo: Dar El Shorouk, 1999), Vol. 7.
- ³² Për më shumë informacione shiko: David Kretzmer, *al-Makanah al-Qanuniyah li al-'Arab fi Israel* (Statusi ligjor i arabëve në Izrael), përkthyer nga Nisrin Mughrabi (Jerusalem: The Center for the Study of Israeli Arab Society, 2002).
- ³³ Iliya Zreiq, "Awda' al-Filastiniyin fi Israel," (Situata e Palestinezëve në Izrael), në *Dalil Israel al-'Am* (Israel:Një Studim Gjeneral), Ed. 2 (Beirut: Institute for Palestine Studies, September 1996), fq. 320.
- ³⁴ *Ibid.*, p. 321.
- ³⁵ Për të pasur më shumë informacione për ligjin e rikthimit, shiko: *Al-Waqa'i' al-Israeliyah* (Faktet Izraelite), *Kitab al-Qawanin* (libri i Ligjeve), *Qanun al-'Awdah* (ligji i rikthimit), 1950, No. 51, fq. 196; dhe për të njohur më shumë për ligjin e shtetësisë referohuni librit: *Al-Waqa'i' al-Israeliyah* (Faktet izraelite), *Kitab al-Qawanin* (Libri i ligjeve), *Qanun al-Muwatanah* (ligji i shtetësisë), 1952, No. 59, fq. 190.
- ³⁶ Për më shumë informacione lexo: Ramadan Babadji et al., *Haqq al-'Awdah li al-Sha'b al-Filastini wa Mabadi' Tatbiqih* (E drejta e rikthimit të palestinezëve dhe parimet e zbatimit të tij) (Beirut: Institute for Palestine Studies, 1996), fq. 6-57.
- ³⁷ Për të parë detajet e këtij ndryshimi juridik, lexo: Nimr Sultani, *Israel wa al-Aqalliyah al-'Arabiyah 2003* (Izraeli dhe minoriteti arab, 2003), përkthyer nga Jalal Hasan (Haifa: The Arab Center for Applied Social Research, 2004), fq. 12-19.
- ³⁸ *Ma'ariv*, 31/7/2003.
- ³⁹ Halil Cohin, *al-Gha'ibun al-Hadirun: Al-Laji'un al-Filastiniyun fi Israel Mundhu 1948* (Prezantimi i mungesës së pronarit: Refugjatët palestinezë në Izrael që prej vitit 1948), Ed. 2 (Beirut: Institute for Palestine Studies, September 2003), fq. 93-94.
- ⁴⁰ Salman Abu Sitta, *Sijil al-Nakbah 1948* (Rregjistrimi i *Nakba* 1948) (London: Centre of Palestinian Return, 1998), fq. 7.
- ⁴¹ Binyamin Nwirger, *al-Nizam al-Siyasi fi Dawlat Israel* (Sistemi Politik në Shtetin e Izraelit) (Tel Aviv: Open University, 1990), fq. 39. (në Hebre)



- ⁴² Shiko: Halil Cohin, *al-Gha'ibun al-Hadirun: Al-Laji'un al-Filastiniyun fi Israel Mundhu 'Am 1948* (Mungesës së pronarit: Refugjatët palestinezë në Izrael që prej vitit 1948), përkthyer nga Nisrin Mughrabi (Jerusalem: The Center for Study of Israeli Arab Society, 2002); and Michael Dumper, *Siyasat Israel Tijah al-Awqaf al-Islamiyah fi Filastin (1948-1988)* (Politika çifute ndaj ndihmave islamike në Palestinë, 1948-1988), Ed. 2 (Beirut: Institute for Palestine Studies, 1992).
- ⁴³ për të pare këto ligje, amendamente dhe ligjin e planeve referohu: Nimr Sultani, *Muwatinun bila Muwatanah: Israel wa al-Aqalliyah al-Filastiniyah 2000-2002* (Qytetarët pa shtetësi: Izraeli dhe minoriteti palestinez, 2000-2002) (Haifa: The Arab Center for Applied Social Research, 2003), fq. 19-47; dhe David Kretzmer, *op. cit.*
- ⁴⁴ Yusuf al-Ghazi, *Haaretz*, 4/3/1998.
- ⁴⁵ *Sawt al-Haq wa al-Hurriyah*, 27/3/1998.
- ⁴⁶ Yusuf al-Ghazi, *Haaretz*, 24/3/1998.
- ⁴⁷ Yusuf al-Ghazi, *Haaretz*, 12/7/1999.
- ⁴⁸ Gideon Alon, *Haaretz*, 12/9/1999.
- ⁴⁹ Yusuf al-Ghazi, *Haaretz*, 15/9/1999.
- ⁵⁰ shiko: revistën, Amal Shehadah, "*al-Qada' fi Israel 'Unsuri*," (Juridiksioni racist çifut), *al-Shuruq*, No. 699, 29/8/2005, fq. 27-28.
- ⁵¹ Sajtet e Arabëve 48, 18/3/2007, shiko:
<http://www.arabs48.com/display.?cid=6&sid=5&id=43852>
- ⁵² shiko: Studimet Akademike: *Ahkam al-Qada' al-Israeli Dudd al-'Arab Tattasim bi al-Tamyiz* (Dënimet çifute ndaj arabëve janë diskriminuese), gazeta *Asharq Alawsat*, London, 28/2/2007.
- ⁵³ Dan Ephron, "Secrets of Unit 1391: Uncovering an Israeli Jail that Specializes in Nightmares," *revista e lajmeve të përjavshme* (Sekretet e njësisë 1391: Zbulimi i një burgu çifut që specializon në ankth) 28/6/2004, fq. 22-23, shiko:
<http://www.newsweek.com/id/54121/output/print>
- ⁵⁴ shiko: gazetën *Annahar*, Beirut, 12/4/2007.
- ⁵⁵ shiko: *Arabs* 48, 28/3/2007.
- ⁵⁶ *Taqrir li al-Hay'ah al-'Ammah li al-Isti'amat* (Komitetet në raportet e informacionit publik), International Journalism Centre, 12/2/2006.



- ⁵⁷ Ibrahim Abu Jabir, “*Al-‘Arab fi al-Manahij al-Israeliyah*,” (Arabët në Kurikulën Izraelite), Centre for Modern Studies, Umm al-Fahim, 3/8/2005.
- ⁵⁸ shiko: Iyad al-Qurra, *Manahij al-Ta‘lim fi Israel wa Nafi al-Akhar* (Plani mësimor në Izrael dhe mohimi i të tjerëve), site i IslamOnline, 11/1/2004.
- ⁵⁹ Shënimet e përkthyesit: Mohammad Abdo Al-Ibrahim, Racist Upbringing, in: <http://www.golan67.net/Articles/racist%20upbringing.htm>
- ⁶⁰ shiko: gazetën *Al-Khaleej*, UAE, 13/1/2007.
- ⁶¹ gazeta *Fusul min al-Tathir al-‘Irqi fi Filastin*, *al-Hayat*, London, 19/4/2007.
- ⁶² *Al-Kitab al-Muqaddas* (Libri i shenjtë), *al-‘Ahd al-Qadim* (Testamenti i vjetër), *Safar al-Tathnia* (Deuteronomy) 20: 16-17.
- ⁶³ *Ibid.*, 7: 1-2.
- ⁶⁴ Bayan al-Hout, *Filastin: Al-Qadiyah, al-Sha‘b, al-Hadarah: Al-Tarikh al-Siyasi min ‘Ahd al-Kan‘aniyin hatta al-Qarn al-‘Ishrin-1917* (Palestina: Shkaqet, njerëzit, civilizimi: Historia politike që prej kohës së kananites deri në shek. e 20-të, 1917) (Beirut: Dar al-Istiqlal li al-Dirasat wa al-Nashir, 1991), fq. 295.
- ⁶⁵ Chaim Simons, A Historical Survey of Proposals to Transfer Arabs from Palestine 1895-1947, The Zionist Crime Collection, Gengis Khan Publishers, 2004, fq. 16-17, see: <http://www.vho.org/aaargh/fran/livres4/simons.pdf>
- ⁶⁶ Nur al-Din Masalha, *Tard al-Filastiniyin: Mafhum al-Transfer fi al-Fikr wa al-Takhtit al-Suhyuniyayn 1882-1948* (Dëbimi i Palestinezëve: Koncepti i transferimit në mendimet politike sioniste, 1882-1948) (Beirut: Institute for Palestine Studies, 1992), fq. 14.
- ⁶⁷ Benny Morris, “Refabricating 1948,” *Journal of Palestine Studies*, Vol. 27, No. 2, Winter 1998, fq. 84-85.
- ⁶⁸ shiko: Nur al-Din Masalha, “*al-Tasawwur al-Suhyuni li al-Tarhil: Nazrah Tarikhiyah ‘Ammah*,” (Vizioni sionist i transferimit: Vështrime të përgjithshme historike), *Journal of Palestine Studies*, No. 7, Summer 1991, fq. 26. (edicioni arabik)
- ⁶⁹ *Ibid.*, p. 29.
- ⁷⁰ sipas deklaramit: Chaim Simons, op. cit., fq. 30.
- ⁷¹ *Ibid.*; and Nur al-Din Masalha, “*al-Tasawwur al-Suhyuni li al-Tarhil*,” (Vizioni sionist për transferimet), fq. 31.
- ⁷² për më shumë informacione, shiko: Nur al-Din Masalha, *Tard al-Filastiniyin* (Dëbimi i palestinezëve), fq. 29-139.



- ⁷³ *Harb Filastin 1947-1948* (Lufta e Palestinës: 1947-1948), *al-Riwayah al-Israeliyah al-Rasmiyah* (Rrëfimet e zyrtarëve çifutë), përkthyer nga Ahmad Khalifah (Beirut: Institute for Palestine Studies, 1986), Introduction.
- ⁷⁴ Siç deklarohet në: Sharif Kana‘nah, *al-Shatat al-Filastini: Hijrah am Tahjir?* (Diaspora palestineze: Emigrim apo dëbim?) (Jerusalem: International Jerusalem Centre for Palestinian Studies), fq. 28-92.
- ⁷⁵ Siç deklarohet në: Tom Segev, *al-Israeliyun al-Awa‘il-1949* (1949: Izraelitët e parë), përkthyer nga Khalid ‘Ayid et al. (Beirut: Institute for Palestine Studies, 1986), fq. 54.
- ⁷⁶ Siç deklarohet në: *Ibid.*, fq. 47-57.
- ⁷⁷ Amos Elon, “The Jew’s Jews,” *The New York Review of Books*, 10/6/1993, fq. 16.
- ⁷⁸ Uzi Binziman and ‘Atallah Mansur, *Muqimun Thanawiyun* (Qytetarët e klasit të dytë) (Jerusalem: 1992), fq. 56-57. (në Hebraisht)
- ⁷⁹ siç deklarohet në: *Ibid.*, fq. 57.
- ⁸⁰ siç deklarohet në: Benny Morris, *Israel’s Border Wars: 1949-1956* (Oxford: Clarendon Press, 1993), fq. 163.
- ⁸¹ Nur al-Din Masalha, *Ard Akthar wa ‘Arab Aqal: Siyasat “al-Transfer” al-Israeliyah fi al-Tatbiq 1949-1996* (Më shumë tokë, më pak arabë: Politika Izraelite e transferimit në zbatim 1949-1996) (Beirut: Institute for Palestine Studies), fq. 29.
- ⁸² Benny Morris, *Israel’s Border Wars*, fq. 154-157.
- ⁸³ Nur al-Din Masalha, *Ard Akthar wa ‘Arab Aqal* (Më shumë tokë, më pak arabë), fq. 29.
- ⁸⁴ shënimet e përkthyesit: “internal refugees” or what is known as internally displaced persons (IDPs).
- ⁸⁵ Nur al-Din Masalha, *Ard Akthar wa ‘Arab Aqal* (Më shumë tokë, më pak arabë), fq. 30.
- ⁸⁶ Tom Segev, *op. cit.*, fq. 33.
- ⁸⁷ Ely Tabur, *Yedioth Ahronoth*, 2/11/1982.
- ⁸⁸ Muhammad ‘Ali Taha, *Fi Daw’ Qarar Ta‘lim Turath al-Transfer li Tullab al-Madaris* (Në Dritën e vendimit, duke i mësuar nxënësve trashëgiminë e transferimit), *al-Mashhad al-Israeli*, 28/12/2005.
- ⁸⁹ Akiva Eldar, *Haaretz*, 23/1/2001.



- ⁹⁰ për më shumë informacion shiko: Tariq Ibrahim, *al-Qatil Wahid wa al-Mas'ulun Kuthur* (Vrasësi është një dhe përgjegjësit janë shumë), fq. 21-23.
- ⁹¹ *Khuttat al-Naqab 2015* (Plani i Zhvillimit të Negev-it 2015), shiko:
<http://www.negev.gov.il/Negev>
- ⁹² *Yedioth Ahronoth*, 28/4/2007.
- ⁹³ Meron Rapoport, History Erased, *Haaretz*, 6/7/2007, shiko:
<http://www.haaretz.com/hasen/spages/878851.html>
- ⁹⁴ shiko: Arab Institute for Human Rights, *Tadnis al-Amakin al-Muqaddasah* (Përdhosja e Shenjtërore), Nazareth, 2005, fq. 9; and *Mudhakkarat Jam'iyat al-Aqsa hawla Awqaf wa Muqaddasat al-Muslimin fi Israel* (Memorandumi i shoqatës al-Aqsa për ndihmat muslimane dhe të shenjtoreve në Izrael), Umm al-Fahim, prill 1994.
- ⁹⁵ Arab Institute for Human Rights, *Tadnis al-Amakin al-Muqaddasah* (Përdhosja e shenjtoreve), fq. 13.
- ⁹⁶ Ra'id Salah, *Sawt al-Haq wa al-Hurriyah*, 17/8/1991.
- ⁹⁷ Michael Dumper, *op. cit.*, fq. 72.
- ⁹⁸ *Sawt al-Haq wa al-Hurriyah*, 17/8/1998.
- ⁹⁹ *Mudhakkarat Jam'iyat al-Aqsa* (Memorandumi i al-Aqsa), fq. 8-15.
- ¹⁰⁰ Arab Institute for Human Rights, *Tadnis al-Amakin al-Muqaddasah* (Përdhosja e Shenjtoreve), fq. 36.



Racizmi Izraelit *Palestinezët në Izrael* *Çështje Studimore*

KY LIBËR

Al-Zaytouna Center ka kënaqësinw e saj të madhe që sjell te lexuesit serin e parë: A Jam Edhe Unë Njeri?

Ky libër synon që të sjellë tek ju vuajtjet e popullsisë palestineze nën pushtimin izraelit. Ky libër nënvizon sesa mizor është ky pushtim. Tërheq vëmendjen ndaj dhunës që ushtron Izraeli kundër palestinezëve dhe shkeljen themelore të të drejtave të njeriut.

Libri i parë fokusohet mbi racizmin në Izrael, veçanërisht racizmit kundër palestinezëve, një çështje me një manifestim racist shumë të qartë i cili vazhdon edhe sot nw shek e 21të; e gjitha kjo ndodh në një kohë kur e tërë bota e qytetëruar po lëviz me shpejtësi drejt koncepteve bazë të respektimit të të drejtave të njeriut, dinjitetit si dhe respektimit të të drejtës së patjetërsueshme të individit, për të jetuar i lirë e në paqe, në atdheun e tij.

1

A Jam Edhe Unë Njeri?

